

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 4-2021

ROLI I ARSIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT

Adelina Gashi

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)

Recommended Citation

Gashi, Adelina, "ROLI I ARSIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT" (2021). *Theses and Dissertations*. 2564.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2564>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

ROLI I ARSIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT
Shkalla Bachelor

Adelina Gashi

Prill / 2021

Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome
Viti akademik 2015-2016

Adelina Gashi

ROLI I ARSIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË VENDIT

Mentor: Dr. Sc. Mirjeta Domniku

Prill / 2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Arsimimi është konsideruar gjerësisht si një instrument udhëheqës i rritjes ekonomike nëpërmjet kontributit të tij në ndërtimin e kapaciteteve të kapitalit human. Përfitimet nga arsimi nuk shihen vetëm për individin e shkolluar, por edhe për ekonominë si një e tërë. Në këtë kontekst, studime të ndryshme, përgjithësisht të shekullit XX, kanë studiuar ndikimin e arsimit në rritjen ekonomike. Zhvillimi i teknologjisë gjatë atyre viteve solli, ndër të tjera, rritjen e numrit të të arsimuarve, me 200 herë më shumë se në vitet 1990 (*Schofer & Meyer, 2005*). Analiza dhe studime të shumta janë kryer rreth përfitimeve që sjell arsimi, mbi rritjen ekonomike, por shumë pak mbi ndikimin e arsimit të lartë mbi rritjen ekonomike. Hipoteza kryesore që shtrohet në këtë punim është se rritja ekonomike afatgjatë varet nga zhvillimi i edukimit, njohuritë dhe zbulimi i ideve të reja, të cilat nxisin inovacionet duke ndikuar në rritjen e produktivitetit. Duke qenë se inovacionet teknologjike rrjedhin prej individëve me arsim të lartë, është shumë i rëndësishëm studimi dhe analizimi i ndikimit të arsimit të lartë në rritjen ekonomike për të zbuluar nëse kjo hipotezë mund të provohet në rastin e Kosovës.

Ky punim analizon ndikimin e arsimit të lartë në rritjen ekonomike si dhe faktorët kryesorë, përfitimet dhe kostot që ka arsimi i lartë në performancën ekonomike të Kosovës. Qëllimi i këtij punimi është të kontribuojë në literaturë duke mundësuar një analizë specifike mbi impaktin që ka arsimi i lartë në rritjen ekonomike.

MIRËNJOHJE DHE FALËNDERIME

Punimi i temës së diplomës kërkon mund dhe përkushtim të madh i cili nuk mund të realizohej pa përkrahjen e njerëzve më të dashur, prandaj ju jam mirënjohëse dhe i falënderoj pafund të gjithë ata që më kanë mbështetur jo vetëm tani por për gjatë gjithë rrugëtimit tim studentor.

Është shumë e vështirë për të gjetur fjalë të duhura për të shprehur falënderime dhe mirënjohje ndaj mentores time Dr.Sc. Mirjeta Domniku e cila në mënyrë të vazhdueshme më përcillte hap pas hapi drejt studimit të punimit me mbështetjen, inkurajimin, dhe udhëzimet e vlefshme të cilat synonin drejt ngritjes së nivelit të punimit.

Një falënderim i veçant shkon për të gjithë profesorët e tjerë të cilët kontribuan me njohurit e tyre gjatë gjithë kohës së studimit dhe kolektivin e fakultetit.

Dhe krejt në fund, një falënderim shumë i sinqert i kushtohet-dedikohet familjes sime të cilët më mbështeten gjatë kohës së studimeve me dashurin e tyre, durimin dhe kurajon si dhe duke më dhënë forcë për të përfunduar me sukses këtë punim.

Mirënjohëse ndaj jush gjithmonë!

Adelina Gashi

Prill, 2021

Prishtinë

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	4
2.1. Rëndësia e arsimit për Kosovën.....	4
2.2. Qëllimi i studimit dhe rezultatet e pritura	5
2.2.1. Ndikimi që ka arsimit në rritje ekonomike.....	6
2.2.2. Si ndikon ekonomia në zhvillim të arsimit?.....	7
2.3. Edukimi cilësor dhe zhvillimi ekonomik.....	8
2.4. Struktura e sistemit të arsimit në Kosovë	11
2.4.1. Analiza e situatës sipas niveleve të arsimit	12
2.4.2. Arsimit Parauniversitar.....	14
2.4.3. Arsimit dhe Aftësimi Profesional (AAP)	18
2.4.4. Arsimit për të rritur dhe arsimit jo-formal.....	23
2.4.5. Arsimit i Lartë	25
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	33
4. METODOLOGJIA	35
5. REZULTATET	36
6. DISKUTIME DHE KONKLUSIONE	40
7. REFERENCAT	41
8. APPENDIXES	43

LISTA E GRAFIKAVE

Grafiku 1. Opinionet e qytetarëve rreth ndikimit të arsimit në zhvillimin ekonomik.....	36
Grafiku 2. Opinionet e qytetarëve se a nevitën të ndërtohen dhe të zbatohen politikat që synojnë rritjen e pjesëmarrjes në arsim në përgjithësi dhe në arsimin e mesëm dhe të lartë në veçanti?	36
Grafiku 3. Opinionet e mësuesve në lidhje me disponueshmërinë me literaturë	37
Grafiku 4. Opinionet e studentëve në lidhje me disponueshmërinë me literaturë.....	38
Grafiku 5. Opinionet e qytetarëve që një ndër shkaqet kryesore të mosvazhdimin të studimeve të larta janë kushtet financiare.....	38

1. HYRJE

Në këtë kapitull do të paraqitet një pamje e përgjithshme në pika të shkurta për punimin dhe qëllimin e këtij punimi.

Rëndësia e arsimit në zhvillimin ekonomik e shoqëror të çdo vendi është një prej temave që kudo në botë diskutohet dhe shtjellohet nga aspekte të ndryshme. Arsimi mund të kuptohet si procesi marrjes së vazhdueshme të diturisë dhe i shkathtësive për jetë i të gjithë njerëzve në institucione arsimore publike dhe jopublike apo marrja e njohurive në mënyrë formale, joformal edhe informale.

Arsimi në çdo aspekt është faktor fundamental i zhvillimit. M'u për këtë, ky sektor pothuajse në çdo vend trajtohet si sektor me prioritet. Në të vërtetë ç'është ajo që njerëzit e arsimuar i dallon nga të tjerët? Pos tjerash, është aftësia e tyre për të eksploatuar teknologjinë e re dhe rrjedhimisht rritjen e produktivitetit të punës, kanë mendje të hapur, kanë njohuri të konsiderueshme për dukuritë shoqërore dhe natyrën, janë më pragmatik etj. Asnjë vend nuk mund të arrijë që të ketë zhvillim ekonomik e shoqëror të mirëfilltë e të qëndrueshëm pa investime në faktorin njeri.

Ekonomistët e njohur botëror si Adam Smith dhe Alfred Marshall, në shekullin 18-të përkatësisht në shekullin 19-të janë preokupuar me investimet në arsim, duke parashtruar pyetjen: Si reflektohen investimet në arsim, në pasurinë kombëtare dhe në shtimin e mundësisë për fitime më të mëdha të njerëzve si individ?! Po ashtu, më vonë edhe ekonomistë të njohur botërorë janë marrë me këtë çështje, ku në bazë të të dhënave empirike kanë dhënë shpjegime lidhur me relacionin ndërmjet arsimimit dhe shtimit ekonomik.

Në ekonomitë e zhvilluara ka vlerësime se për çdo vit të arsimimit të një individi shtohet mundësia që ai t'i rrisë fitimet në shkallë relative 10%. Masa e investimeve në arsim ndryshon nga shteti në shtet, varësisht nga potenciali ekonomik dhe nga prioritetet dhe politikat që ka përcaktuar vendi përkatës. Në bazë të të dhënave, SHBA-ja është shteti, i cili më së shumti ndan para për arsim. Sidoqoftë, një indikator i rëndësishëm sigurisht është përqindja e bruto produktit vendor (GDP) i ndarë për zhvillim të arsimit të çdo vendi të botës, e posaçërisht masa absolute e mjeteve financiare. Tash më kur

është kuptuar roli i arsimit në zhvillim të përgjithshëm ekonomik e shoqëror të çdo vendi, bëhet përpjekje që të investohet sa më shumë në të.

Siç dihet, në investime arsimore përfshihen buxheti i dedikuar për ngritje dhe renovim të objektet arsimore, blerjen e pajisjeve laboratorike, rregullimin e infrastrukturës dhe ambienti të jashtëm, për sigurimin e pagave të mësimdhënësve, ndarja e subvencioneve të ndryshme për nxënës e student, reformimin dhe rishikimin e planeve dhe të programeve mësimore, krijimi i mundësive për mobilitet etj. Veçanarisht investimet duhet të jenë në funksion të shtimit e cilësisë së arsimit, meqenëse kjo siguron zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror. Easterlin thekson se deri në vitin 1850 shumë pak njerëz jashtë Evropës Veriperëndimore dhe SHBA-ve kishin pasur ndonjë arsim formal. Në Afrikë dhe në shumë vende të Azisë dhe Amerikës Latine, kjo gjendje e mungesës së arsimit ka qenë e pranishme deri në vitin 1940. Shkalla më e lartë e arsimimit i bën punëtorët që të jenë në gjendje që më lehtë dhe më shpejt të adaptohen në një punë të re, por njëkohësisht të kenë aftësi më të mëdha komunikimi.

Arsimimi ndikon po ashtu edhe në rritjen e standardit jetësor në përgjithësi, siguron nga fakti se njeriu i arsimuar din ta rregullojë jetën e vet më mirë, në kushtet e tjera të njëjta. Asnjë vend nuk ka arritur që të ketë zhvillim ekonomik konstant pa investime të konsiderueshme në kapitalin njerëzor.

Zhvillimi i hovshëm i shkencës dhe i teknologjisë ka bërë që të përqafohet ideja e mësimimit tërë jetësor dhe gjithë përfshirja e popullatës në këtë. Sidoqoftë, vendet e ndryshme dallohen jo vetëm për nga kuantitet apo masoviteti, por Arsimi është faktor fundamental i zhvillimit edhe për nga kualiteti i arsimit. Zhvillimi i arsimit dhe zhvillimi ekonomik kanë një lidhshmëri mjaft funksionale dhe ndikim reciprok njëkohësisht.

Është bërë pothuajse praktikë e rëndomë që të vihet në pah vetëm roli i arsimit në zhvillim të ekonomisë, por jo edhe roli i ekonomisë në zhvillim të arsimit. Vlen të ceket se cilësia e arsimit veçanërisht është komponentë që ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të çdo vendi. Tendencat dhe përcaktimi i Kosovës për integritime evropiane nënkupton, pos tjerash, hyrje në një sistem gare me vende të tjera në çdo pikëpamje, edhe kur është fjala për dituri, thithjen e investimeve, zgjidhjen e sfidave të ndryshme në përmasa globale dhe kombëtare. Kjo gjë është vërejtur dhe është studiuar historikisht

në vende të ndryshme të botës. Kur flitet për arsimim, natyrisht se aludohet në dituri, shkencë etj. Ka mendimtarë që diturinë e identifikojnë me fuqi, pra këtu mendohet në nivel të zhvillimit të forcave prodhuese, aftësive inovacioni dhe shkence, implementimi i zbulimeve nga të gjitha fushat në ngritje të mirëqenies njerëzore etj.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Ky kapitull është ndarë në disa pjesë që ndihmojnë për të krijuar kuadrin teorik të të gjithë punimit në mënyrë të qartë dhe logjike, ku është shqyrtuar literatura që përfshinë efektet e arsimit të lartë në rritjen ekonomike të një vendi, rëndësia e arsimit për Kosovën, domosdoshmëria për arsim dhe aftësim profesional dhe cilësor, struktura e sistemit të arsimit në Kosovë etj.

2.1. Rëndësia e arsimit për Kosovën

Në kushtet e ekonomisë së re, ekonomisë së bazuar në dituri, kapitali njerëzor i mishëruar në popullsinë e Kosovës është aset ekonomik më i rëndësishëm i vendit. Ashtu si edhe në vendet e tjera, suksesi i sistemit arsimor Kosovës në ofrimin e shkathtësive kyçe që kërkohen në tregun e punës do të jetë i një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Qasje e barabartë në një sistem arsimor modern është gjithashtu një faktor po aq i rëndësishëm për promovimin e barazisë dhe mirëqenies sociale si dhe për rritjen e mirëqenies së minoriteteve dhe grupeve të disfavorizuara (të marginalizuara). Përmirësimi i standardeve të arsimit stimulon zhvillimin ekonomik në mënyrë direkte nëpërmjet efektit të tij në produktivitetin e punëtorëve. Për më tepër forca punëtore e arsimuar është më fleksibile dhe e adaptueshme dhe si rrejdhim i përgjigjet më mirë nevojave në ndryshim e sipër të ekonomisë Kosovare dhe Evropiane. Edhe hulumtimet në lidhje me tregun e punës, sistemin e arsimit dhe kapitalin njerëzor në Kosovës tregojnë se në aspektin individual, niveli i shkollimit është një përcaktues kryesor si i probabilitetit për të siguruar dhe mbajtur vendin e punës, ashtu edhe për nivelin e të ardhurave në Kosovë ata që janë më të arsimuar kanë më shumë mundësi për të qenë të punësuar dhe për të ardhura më të larta. Mbi të gjitha, nivelet e larta të arsimit të popullsisë në përgjithësi nxisin ndërmarrësinë si faktor i rëndësishëm i gjallërimit ekonomik.

Një faktor tjetër veçanërisht i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës është arsimimi modern që promovim shkathtësive kyçe të cilat nxisin vetëpunësimin. Së fundi, nivelet më të larta të rezultateve në arsim rrisin shanset e Kosovarëve për të konkurruar me sukses në tregjet e huaja të punës, krahas tregut të brendshëm. Hulumtimet tregojnë

se niveli më i lartë i arsimit i personave në forcën e punës rritet probabilitetit për të punuar jashtë. Pra me nivele më të larta të arsimit, remitancat për kokë nga Kosovarët që punojnë jashtë do të rriten dhe nëse edhe gjasat për punë jashtë rriten, këto remitanca do të rriten edhe më shumë. Për këto arsye shpenzimet në arsim duhe të shihn si investime, kthimet nga të cilat do të përshpjetojnë rritjen ekonomike.

Duke parë rëndësinë gjithmonë e më të madhe të arsimit të lartë në zhvillimin ekonomik, urgjentisht nevojiten të ndërtohen dhe të zbatohen politikat që synojnë rritjen e pjesëmarrjes në arsim në përgjithësi dhe në arsimin e mesëm dhe të lartë në veçanti (Lauder, H., P. Brown & D. Ashton, 2008).

2.2. Qëllimi i studimit dhe rezultatet e pritura

Ky studim përpiqet të analizojë efektet e arsimit të lartë në rritjen ekonomike të një vendi dhe rasti që është marrë në studim është Kosova. Edhe pse zhvillimi i arsimit të lartë është thelbësor për zhvillimin social dhe ekonomik të një kombi, përfitimet më të gjera shoqërore apo kombëtare të arsimit të lartë, kanë tërhequr më pak vëmendje. Ka një rëndësi shumë të madhe ndikimi i arsimit të lartë, pasi sjell përfitime individuale më shumë sesa përfitime kombëtare.

Nga perspektiva e politikave për të arritur rezultate më të mira, del një tablo e thjeshtë. Së pari, dëshmitë nga hulumtimet e gjera tregojnë qartë se "politikat e pastra të burimeve".

Politikat që thjesht sigurojnë më shumë burime brenda strukturës aktuale nxitëse të shkollave brenda shumicës së vendeve - nuk ka të ngjarë të prodhojnë fitime thelbësore sistematike në rezultatet e nxënësve. Ka sigurisht kualifikime dhe paralajmërime. Disa shkolla do të përdorin burime shtesë në mënyrë efektive. Dhe, disa sisteme që nuk ofrojnë burime minimale, siç janë tekstet bazë, mund të përmirësojnë nëse burimet janë aplikuar në zonat kyçe të mungesës. Sidoqoftë, vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim demonstrojnë një lidhje të pamundur, por të prekshme midis zgjidhjeve të thjeshta të resurseve dhe arritjeve të nxënësve. Së dyti, provat rreth asaj se çka konkretisht llogaritet në aspektin e shkollave është mjaft e kufizuar. Por, kandidati qendror është cilësi e lartë e mësuesve. Fatkeqësisht, karakteristikat e mësuesve të mirë nuk kuptohen mirë, duke e bërë shumë të vështirë zgjidhjet rregullatore dhe duke mbështetur

zhvillimin e shpërblimeve për mësimdhënie me cilësi të lartë. Për këtë rezultat, shumica e vendeve - si të zhvilluara ashtu edhe ato në zhvillim kanë sisteme nxitëse të përfshira në pagat e mësuesve dhe aranzhimet kontraktuale të mësuesve që i rezistojnë ndryshimeve të rëndësishme dhe që nuk janë në linjë me cilësinë e mësimdhënësve. Së treti, çelësi i përmirësimit duket se qëndron në stimuj më të mirë - stimuj që do të çojnë drejt menaxhimit të kyçur në performancën e nxënësve dhe që do të nxisin shkollat e forta me mësuesit me cilësi të lartë. Këtu, tri politika të ndërlidhura dalin përpara: nxitja e më shumë konkurrencës, në mënyrë që kërkesa prindërore të krijojë stimuj të fortë për shkollat individuale; autonomia në vendimmarrjen lokale, në mënyrë që shkollat individuale dhe udhëheqësit e tyre të ndërmarrin veprime për të nxitur arritjet e nxënësve; dhe një sistem llogaridhënës që identifikon performancën e mirë të shkollës dhe çon në shpërblime bazuar në këtë.

2.2.1. Ndikimi që ka arsimi në rritje ekonomike

Arsimi nuk ka të bëjë vetëm me të mësuarit dhe marrjen e notave të mira, por është shumë më shumë se kaq. Çka në të vërtetë përfaqëson më shumë është të mësuarit e fenomeneve të reja për të cilat nuk dimë shumë dhe që kanë për qëllim zgjerimin e dijes sonë. Një person i arsimuar di të dallojë të drejtën nga e gabuara e të keqen nga e mira kjo është ajo që të lë impakt kur dëgjon fjalën "i arsimuar" (Barr, 2013).

Nga këndvështrimi teorik, janë të paktën tre mekanizma përmes të cilëve arsimi mund të ndikojë në rritje ekonomike. Fillimisht, në pikëpamjen mikroekonomike, arsimi rrit kapitalin njerëzor të qenësishëm në fuqinë punëtore, e cila rrit produktivitetin e punës dhe kështu do të ketë rritje ekonomike në mënyrë të vazhdueshme drejt një niveli më të lartë të ekuilibrit të prodhimit. Së dyti, arsimi mund të rrisë kapacitetin inovativ të ekonomisë, si dhe njohuritë e reja për teknologjinë, produktet dhe proceset e reja që nxisin rritje. Së treti, arsimi mund të lehtësojë përhapjen dhe transmetimin e njohurive të nevojshme për të kuptuar dhe përpunuar informacionet e reja dhe për të zbatuar me sukses teknologjinë e re të hartuar nga të tjerët, të cilat përsëri promovojnë rritje ekonomike (GPE, 2013).

Por, a ndikon më shumë rritja e cilësisë së arsimit në rritjen e zhvillimit ekonomik apo zhvillimi ekonomik në ngritjen e cilësisë në arsim? Nuk është e lehtë që të jepet një përgjigje definitive për këtë. Të dy konstatimet kanë avantazhet dhe pikat e tyre të dobëta. Sipas pikëpamjes së parë, në mënyrë që një vend të ketë zhvillim ekonomik dhe shoqëror, bazë për ta duhet të jetë njeriu i arsimuar në institucione cilësore të arsimit. Sipas pikëpamjes së dytë, po që se nuk investohet në arsim atëherë edhe cilësia vështirë se do arrihet. Duhet të ketë paga më të larta për mësuesit, fonde më të mëdha për analiza dhe hulumtime, investime në laboratorë dhe teknologji informative në mënyrë që zhvillimi ekonomik të rrisë cilësinë në arsim, e kjo mund të arrihet vetëm nëse buxheti shtetëror ka mjete të mjaftueshme për investime në arsim (Bokova, 2010).

2.2.2. Si ndikon ekonomia në zhvillim të arsimit?

Është e kuptueshme se vendet me nivel të ulët të zhvillimit (bruto produkt vendor, investime dhe buxhet shtetëror të ulët), nuk mund të ndajnë mjete të mjaftueshme për intensifikim të arsimit dhe e kundërta.

Ekonomia në zhvillim të arsimit reflekton: Në sigurimin e masës së buxhetit për investime kapitale dhe shpenzime të tjera në funksion të krijimit të kushteve sa më të mira në shkollë; Në motivimin e mësuesve duke siguruar nivel të pranueshëm të pagave; Në krijimin e kushteve për hapjen e vendeve të punës për të rinjtë dhe ekspertët dhe të kualifikuarit tjerë; Në krijimin e mundësive të aftësisë praktik të nxënësve dhe studentëve; Në ofrimin e informatave cilësore dhe sasore për sistemin arsimor, për atë se cilat profile të ekspertëve kërkon tregu aktualisht dhe në të ardhmen në vendin përkatës; Në zvogëlimin e dukurisë së braktisjes së shkollimit të nxënësve të të gjitha niveleve të arsimit.

Pa ekonomi të zhvilluar dhe rrjedhimisht pa masë të konsideruar të buxhetit dedikuar për arsim, nuk mund të ndahen fonde për arsim. Pa ekonomi të zhvilluar nuk mund të ndodhë absorbimi i njerëzve të diplomuar. Në të kundërtën, do të vihej në situatë kur të diplomuarit, duke mos gjetur angazhim në profesionet e tyre ose të ngjashme, do të detyroheshin ose migrojnë, ose të sillen në situatë, që të harrojnë dituritë e marra. Në të dy rastet do të bëhet humbja e investimeve të bëra për këtë qëllim. Konkurrenca gjithnjë

e më e madhe ndërmjet vendeve të industrializuara për prodhime dhe shërbime cilësore është në lidhshmëri të ngushtë me zhvillimin e shkencës, teknologjisë dhe të arsimit.

Ndoshta m'u këto rrethana kanë bërë që arsimit të marrë karakter të një procesi shumë dinamik. Sipas botëkuptimeve të Programit Zhvillimor të Kombeve të Bashkuara (UNDP), baza materiale apo niveli i caktuar i zhvillimit ekonomik, si dhe arsimimi mundësojnë zhvillimin human, si koncept më i gjerë se vetë zhvillimi arsimor apo ai ekonomik, shikuara ndaras. Pra mund të thuhet se kemi zhvillim human në një vend të caktuar vetëm atëherë kur gërshetohen në mes vetes: zhvillimi i arsimit cilësor, shtimi ekonomik dhe ngritja e mirëqenies.

Nisur nga ky botëkuptim dhe indikatorë e zhvillimit makroekonomik mund të thuhet, se në pjesën dërrmuese të vendeve të rajonit, e aq më pak në Kosovë aktualisht mund të bëhet fjalë për zhvillim human të mirëfilltë. Si pasojë e mungesës së kësaj, njerëzit e këtyre vendeve shpesh herë nuk mund t'i zhvillojnë të gjitha potencialet e tyre në masë të duhur dhe m'u për këtë arsye është e pranishme dukuria e "ikjes së trurit" kah vendet e zhvilluara. Bazuar në këtë, del së ekonomisë dhe arsimit duhet dhënë rëndësi njëkohësisht, duke krijuar politika të favorshme me efekte të ndërsjella. Nuk do të ishte e mjaftueshme që vetëm të numërojmë të diplomuarit, duke mos krijuar parakushte të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të mundësisë që ata të diplomuar të materializojnë dhe të valorizojnë diturinë e tyre në interesin personal dhe të shoqërisë. Mund të thuhet se resori i arsimit të një qeverie nuk mund të jetë i kënaqur nëse pjesës dërrmuese e të diplomuarve nuk i jepet mundësia që shkathhtësitë e fituara t'i shfrytëzojnë për ngritjen e mirëqenies së tyre personale dhe zhvillimin e vendit. Ka mendime se të rinjtë e diplomuar e të cilët në vazhdimësi nuk mund të gjejnë punë, mund të jenë burim i pakënaqësive dhe i destabilizimit në një shoqëri. Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik paraqet faktor limitues në zhvillim cilësor të arsimimit dhe pamundëson arritjen e standardeve të pranuar ndërkombëtarisht (Bowen, W.G., 1963).

2.3. Edukimi cilësor dhe zhvillimi ekonomik

Arsimi përveç që është e drejtë njerëzore themelore, arsimit po ashtu është motor për zhvillimin ekonomik. Gjendja e përgjithshme arsimore e popullësisë së një shteti pjesërisht përcakton nivelin e arsimit të fuqisë punëtore të atij shteti (ku përfshihen

njerëzit që punojnë si të punësuar apo vetë-punësuar, ndërmarrësit, menaxherët, zyrtarët dhe shumë profesione tjera). Disa shtete i theksojnë komponentët e ndryshëm të arsimit. Për shembull, një shtet që nuk ka program arsimor profesional në shkollat e mesme nuk do të ketë fuqi punëtore ‘të shkathtë’. Fakti që njerëzit janë aset më i rëndësishëm nuk është i ri: koncepti “Shoqëria e dijes” i referohet shoqërisë dhe ekonomisë së bazuar në dijen e njerëzve të tyre. Në sistemet tregtare botërore është më pak e rëndësishme ku i gjeni resurset natyrore: më e rëndësishme është nëse shteti ka njerëz që e dinë dhe kuptojnë si t’i përdorin ato resurse për rezultate optimale, të shpikin njohuri, teknika dhe procese të reja dhe i përdorin ato në të njëjtën kohë për përfitime individuale apo përfitime të shoqërisë në përgjithësi. Ky është lajm shumë i mirë – për të gjitha shtetet! Pasi që ne nuk mund të ndryshojmë përbërjen gjeologjike të tokës dhe gurëve, ne mund të ngrisin nivelin e arsimit të përgjithshëm në shoqëri në masë të madhe brenda një periudhe të caktuar kohe. Shkathtësitë kognitive të popullësisë janë faktor i rëndësishëm për rritje ekonomike. Pasi që edukimi cilësor ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi zhvillimin ekonomik të një shteti, ai është më shumë në qendër të raportimit, ku sasia nuk vëhet në fokus. Për të ngritur nivelin e arsimit, nuk është e mjaftueshme të zgjatet koha për arsimim, apo thjeshtë vitet e shkollimit. Prof. Eric A. Hanushek nga SHBA-ja dhe Prof. Ludger Woeßmann nga Gjermania kanë analizuar së bashku marrëdhënien mes arsimit (duke u bazuar në testet ndërkombëtare) dhe performancës ekonomike të shteteve të shumta rreth botës. Rezultatet tregojnë se dallimet në arritjet në mësimnxënie janë më të rëndësishme në shpjegimin e dallimeve mes shteteve në rritjen ekonomike se sa dallimet në mesataren e viteve të shkollimit apo shkallët e regjistrimit të nxënësve/studentëve. Ata përfundojnë: Duke u bazuar në hulumtimet e tyre, ata theksojnë se çdo qasje drejt cilësisë më të mirë arsimore duhet të adresojë faktorë të ndryshëm në të njëjtën kohë; nuk është e mjaftueshme dhe madje as e mundshme të rriten shkathtësitë njohëse pa fuqizuar në të njëjtën kohë strukturën themelore të shkollave! Nga analiza pikëpamjet më të rëndësishme janë: Cilësia e performancës dhe trajnimit të mësimdhënësve ka ndikim të fuqishëm në rezultatet e nxënësve; Zhvillimi i sistemeve të llogaridhënies bazohet mbi testet e arritshmërisë kognitive të nxënësve për të dhënë shpërblime për performancën e mirë edhe për personelin e shkollës edhe për nxënësit.

Përveç cilësisë së arsimit dhe kualifikimit pasues të fuqisë punëtore ekziston një aspekt tjetër i zhvillimit ekonomik në të cilin arsimi mund të luajë rol qendror. Në botën e

sotme asnjë ekonomi nuk mund të përparojë e vetme: në botën e sotme të gjitha shtetet janë të ndërlidhura dhe varen nga njëra tjetra. Prandaj bashkëpunimi ekonomik dhe investimet e huaja direkte janë të rëndësishme për secilin shtet për të plotësuar resurset e veta dhe për të siguruar punësim dhe perspektivë për të gjithë qytetarët. Shtetet edhe garojnë edhe bashkëpunojnë edhe kjo është arsyeja pse është aq e rëndësishme të keni një sistem të fuqishëm arsimor. Në mbarë botën, të gjithë shtetet janë duke konkurruar për investime të huaja direkte për t'u përpyetur apo thjeshtë për të mbijetuar – shumë shtete mundohen të fitojnë investimet direkte të kompanive të huaja në shtetin e tyre duke ofruar shpërblime siç janë takast e zvogëluara dhe infrastruktura e mirë. Përkundër rëndësisë së këtyre shpërblimeve, prania e fuqisë punëtore të aftë, qytetaria e bazuar në dije, sistemi i besueshëm ligjor dhe paqja e qëndrueshme sociale në vend janë përcaktuesit kryesor të vendimeve për investime të korporatave.

Arsimi është “barazues”! Në kontekstin e hulumtimeve të tyre mbi arsimin dhe rritjen ekonomike Prof Hanushek dhe Prof Woeßman theksojnë: “Reduktimi i pabarazive në qasje dhe cilësi arsimore janë dy qëllimet që duhet të ndiqen në të njëjtën kohë që çfarëdo reforme në arsim të jetë e suksesshme” (Hanushek. A. E. & Wobman, L., February 2007).

2.4. Struktura e sistemit të arsimit në Kosovë

Sistemi i arsimit në Kosovë përfshinë 6 nivele formale të arsimit dhe është i strukturuar në bazë të parimeve të mësimi tërë jetësor sipas Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (ISCED). Nivelet e arsimit prej 0 deri në nivelin 3 përbëjnë nivelet e arsimit para-universitar dhe rregullohen me Ligjin për Arsimin Para-universitar. Niveli 4 pas-sekondar në shkollat e arsimit dhe aftësimi profesional rregullohet me Ligjin e Veçantë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, ndërsa nivelet 5 dhe 6 të ISCED rregullohen me Ligjin për Arsimin e Lartë. - Në bazë të Ligjit të Arsimit Para-Universitar dhe në përputhje me nivelet e ISCED, niveli zero (0) përfshinë dy kategori të arsimit; 1) arsimin parashkollor (zhvillimin e fëmijërisë së hershme) për moshën prej 0 deri në 5 vjeç e cila nuk është pjesë e shkollimit të detyruar, dhe 2) arsimin para-fillor për moshën për moshat 5-6 vjeç e cila është pjesë e shkollimit të detyruar.

- Niveli 1 sipas ISCED përfshinë arsimin fillor që zgjat 5 vite, moshë 6-10 vjeçare, respektivisht klasat I-V.
- Niveli 2: arsimi i mesëm i ulët që zgjat katër vite, normalisht, moshë 11 deri 14 vjeçare, respektivisht klasat VI-IX.
- Niveli 3: arsimi i mesëm i lartë i cili zgjatë 3 vite, varësisht nga kurrikula e përcaktuar nga Ministria, moshë 15-17 vjeçare, përfshirë gjimnazin, shkollën e mesme profesionale, shkollën e muzikës dhe atë të artit.
- Niveli 4: Arsimi post-sekondar në institucionet e arsimit dhe aftësimi profesional në periudhën 1 deri 2 vite, zakonisht nga moshë 18 vjeçare e më shumë.
- Niveli 5: Arsimi universitar
- Niveli 6: Arsimi pas universitar Shkollimi i detyruar fillon në fillim të vitit shkollor pas datës kur fëmija arrin moshën 6 vjeçare që është moshë minimale për shkollimin e detyruar dhe përfundon në fund të nivelit 2 të ISCED-it. Në bazë të Ligjit të Arsimit Para-Universitar, shkollimi i detyruar ofrohet falas.

2.4.1. Analiza e situatës sipas niveleve të arsimit

Arsimi para-shkollor - Në mesin e sektorëve të arsimit, arsimi parashkollor dhe para-fillor nuk ka qenë një ndër prioritetet kryesore gjatë dekadës së fundit. Vetëm këto vitet e fundit ka filluar t'i kushtohet më shumë vëmendje nga institucionet e Kosovës sikurse edhe nga donatorët. Në aspekt të legjislacionit, Kosova ka miratuar Ligjin për Arsimin Para-Shkollor në vitin 2006 i cili ka vënë bazën ligjore për rregullimin dhe përmirësimin e arsimit para-shkollor. Arsimi para-shkollor rregullohet gjithashtu edhe me disa dispozita të Ligjit për Arsimin Para-Universitar i rishikuar dhe miratuar në vitin 2011. Pastaj në vitin 2011 janë miratuar udhëzimet administrative për licencimin dhe regjistrimin e ofruesve privat të arsimit para-shkollor dhe për vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta. Së fundi në vitin 2011 janë zhvilluar Standardet e Mësimin në Fëmijërinë e Hershme në bazë të të cilit është krijuar grupi punues për rishikimin dhe zhvillimin e kurrikulave të miratuara në vitin 2006 për fëmijët e grup moshës 0-3 dhe 3-6 vjeç. Arsimi para-shkollor në Republikën e Kosovës aktualisht është i organizuar si në vijim; Në institucione publike (kopshte që përfshijnë fëmijët e grup moshave 1-3 dhe çerdhet që përfshijnë fëmijët 3-6 vjeç; Në institucione private (kopshte për fëmijët 5-6 vjeç); Në klasat për para fillor (fëmijët e moshës 5-6 vjeç, kryesisht në klasa për para fillor të shkollave të rregullta); Në qendra me bazë në komunitet; Shërbimet kryesisht financohen përmes pagesave të shfrytëzuesve nga prindërit dhe shumë institucione janë private; Arsimi parashkollor është përgjegjësi e komunave (Bellaqa, etj., 2012).

Bazuar në statistikat e arsimit të MASHT-it për vitin 2011-2012, numri total i fëmijëve për këtë vit akademik ka qenë 25,451, ku 5,167 në parashkollor dhe 20,284 në para-fillor me gjithsej 800 grupe. Në total janë 41 institucione parashkollore. Në parashkollor, 47.5% (12429) e fëmijëve janë femra, 52.5% (13022) janë meshkuj, 98.2 % janë shqiptar dhe 1.8% janë nga minoritetet, duke përfshirë komunitetin Serb. Në para-fillor, 50.8% janë meshkuj, 49.2% janë femra, 96.3% janë shqiptar dhe 3.7% janë nga minoritetet duke përfshirë komunitetin Serb. Mesatarja e numrit të fëmijëve për grup në arsimin para-fillor është 25. Në total për parashkollor dhe para-fillor, 51.2 % janë meshkuj dhe 48.8 % janë femra. Numri i personeli mësimdhënës për vitin akademik 2011/2012 në arsimin parashkollor është 780, ku 477 ose 61% janë edukator,

65 apo 8.3% janë personel administrativ dhe 238 apo 30.5% janë personel mbështetës. Niveli i përfshirjes së fëmijëve nga komunitetet në institucionet e arsimit parashkollor vazhdon të jetë i ulët. Gjatë vitit 2008/2009 vetëm 319 nga 5,091 fëmijë kanë qenë të regjistruar në arsimin parashkollor nga komunitetet minoritare. Duke pasur parasysh statistikën e vijueshmërisë në arsimin parashkollor, Kosova ka një nivel të ulët të përfshirjes në arsimin parashkollor (në mesin e grupmoshave 3-5 vjeç), është vlerësuar të jetë më pak se 10%, dhe rreth 70% mbulueshmëri për arsimin para fillor (mosha 5-6 vjeç), diçka që mund të ketë ndikim shumë të madh në zhvillimin dhe arritjet në mësim përgjatë tërë edukimit. Bazuar në raportin e UNICEF-it 2010 Kosova ka regjistrimin më të ulët në parashkollor në Evropën Qendrore dhe Jug-Lindore. Shumica e kopshteve dhe çerdheve si dhe klasave para fillore gjenden në qendrat urbane, duke lënë shumicën e fëmijëve nga zonat rurale të pa përgatitur për arsimin fillor. Iniciativat e fundit të politikave për rritjen e qasjes në arsimin parashkollor nuk janë mbështetur me burime të nevojshme.

Rekomandimet kryesore

- Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsimin parashkollor dhe para fillor.
- Alokimi i fondeve nga niveli qendror për arsimin parashkollor për komunat.
- Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të edukatorëve për zhvillimin e hershëm të fëmijës 0-6 vjeç.
- Zhvillimi i programeve për menaxhimin e zhvillimit të hershëm të fëmijës (0-6 vjeç).
- Zhvillimi i kurrikulave për moshën 0-3 vjeç dhe rishikimi i kurrikulave për grup moshën 3- 6 vjeç në aspekt të zhvillimit të hershëm.
- Zhvillimi i një plani afat gjatë për rritjen e numrit të edukatoreve për arsimin parashkollor.
- Forcimi i Fakultetit të Edukimit si institucioni kryesor i cili prodhon edukator për arsimin parashkollor
- Zhvillimi i aktiviteteve vetëdijësuese.
- Zhvillimi dhe inkurajimi i partneriteteve publike private për të mbështetur arsimin parashkollor dhe para fillor.
- Zhvillimi i udhëzimeve për përfshirjen më të madhe të familjes në përmirësimin dhe vlerësimin e programeve. (Zariqi, 2013)

2.4.2. Arsimi Parauniversitar

Është duke u rishikuar dhe finalizuar korniza ligjore në mënyrë që të harmonizohet me politikat dhe zhvillimet e reja në sektorin e arsimit. Vetëm gjatë tri viteve të fundit janë miratuar më shumë se 20 udhëzime administrative. Ligji për Arsimin Para-Universitar është rishikuar dhe miratuar në vitin 2011 i cili është harmonizuar me Ligjin për Arsimin në Komuna. Ligji sjell kërkesa të reja sa i përket trajnimit të mësimitdhënësve, krijon një status të ri të punësimit të mësimitdhënësve si dhe transferimin e përgjegjësisë nga komunat në shkolla. Në bazë të Ligjit, arsimi para-universitar përfshinë fëmijët e moshës 6-18 vjeç përgjatë tri niveleve të arsimit parauniversitar: shkolla fillore (klasat 1-5), shkolla e mesme e ulët (klasa 6-9), shkolla e mesme e lartë (klasa (10-12/13), ku dy nivelet e para janë pjesë e shkollimit të obliguar. Arsimi parauniversitar përbën nën sektorin më të madh në sistemin arsimor të Kosovës. Qeveria e Kosovës është duke implementuar reforma sa i përket decentralizimit të ofrimit të shërbimeve. 36 komuna të Kosovës tanimë kanë një rol të rëndësishëm në menaxhimin e arsimit dhe parimet e financimit dhe buxhetit për komuna janë strukturuar në përputhje me Ligjin për Qeverisje Lokale. Ligji për Arsimin në Komuna është miratuar në maj 2008 dhe rregullon organizimin e institucioneve publike të arsimit në të gjitha nivelet si dhe përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat e MASHT-it dhe komunave në fushën e arsimit. Kjo përbën një hap pozitiv në procesin e reformimit të arsimit por gjithashtu paraqet edhe njëri nga sfidat kryesore meqë kërkon ngritje substanciale të kapaciteteve për menaxhimin dhe planifikimin e arsimit në komuna dhe në nivel të shkollës. Është miratuar Korniza Kombëtare e Kurrikulit e bazuar në kompetenca dhe e cila inkurajon mësimin gjatë gjithë jetës, ndërsa janë duke u hartuar kurrikulat dhe silabusët lëndore për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm. KKK-ja ndryshon qasjen drejtë të mësuarit më aktiv, individual, pjesëmarrës, gjithëpërfshirës dhe drejtë krijimit të nxënësve të cilët do të jenë të përshtatshëm për nevojat shoqërisë bashkëkohore. Kjo qasje e re e të mësuarit do të ketë nevojë për shkathtësi të reja për të qenë në hap me dituritë e reja, idetë pedagogjike dhe teknologjinë re (Shkenca dhe Teknologjia në Kosovë, 2008).

Një nga sfidat kryesore në arsimin special mbetet numri i ulët i personelit të kualifikuar. Përderisa janë 146 të edukatorë të punësuar në shkollimin fillor, vetëm 23 janë të

punësuar në nivelin sekondar dhe asnjë nuk është i punësuar në shkollimin para-fillor. Arsimi special financohet nga niveli qendror, ndërsa komunat nuk ndajnë buxhet për arsimin special në shkollat e tyre të rregullta dhe kjo ndikon në burimet financiare të kufizuara. MASHT-i është në proces të hartimit të planit të veprimit 2012-2016 për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta. Ngjashëm, MASHT-i është në proces të krijimit të ekipeve komunale për vlerësimin e nevojave të arsimit special në të gjitha komunat. Tanimë MASHT ka miratuar Udhëzimin Administrativ për vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta (2012). Është paraqitur roli i Mësimdhënësit për Arsimin Inkluziv në tri shkolla të rregullta dhe këta mësimdhënës janë duke ofruar shërbime për 40 nxënës me nevoja të veçanta të përfshirë në klasa të rregullta (2009). Është planifikuar që do të rritet numri i mësimdhënësve inkluziv, duke përfshirë edhe institucionet e arsimit parashkollor dhe para fillor. Të gjitha shkollat e reja të cilat janë ndërtuar apo që janë duke u ndërtuar plotësojnë kushtet për fëmijët me nevoja të veçanta. Përfshirja në arsim dhe luftimi i braktisjes së shkollimit mbetet sfida e madhe për arsimin Kosovar. Përderisa niveli i vijueshmërisë së shkollimit në tri nivelet e para të shkollimit sekondar është i lartë, përderisa bie në 90% duke iu afruar fundit të shkollimit të mesëm sekondar. Për më tepër, 83% e nxënësve kalojnë nga shkolla e mesme e ulët në atë të lartë (2008- 2009). Vijueshmëria në shkollën e mesme të lartë është shumë e ulët, 53.4%. Më pak se gjysma e fëmijëve të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian vijnë në arsimin fillor; më pak se 20% janë mbi moshën 12; 4% përfundojnë shkollimin e mesëm dhe rreth 40 të rinj nga komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian ndjekin studimet në arsimin e lartë. Këto statistika tregojnë qartë nivelin e braktisjes së mësimin gjatë ngjitjes së niveleve të arsimit. Siç mund të shihet nga statistikat më lartë, niveli i braktisjes së shkollimit është shumë i lartë. Një në dy të rinj braktisin shkollimin para moshës 18 vjeç. Dy në tre të rinj braktisin shkollimin pa marrur kualifikimin përkatës. Është vlerësuar se 12% është braktisja e shkollimit të obliguar dhe 28% e nxënësve nuk përfundojnë shkollimin e mesëm. Posaçërisht sa i përket shkollimit të vajzave, Kosova është shumë larg vendeve Evropiane dhe kalon edhe shumicën e vendeve fqinjë. Regjistrimi i vajzave në shkollimin e mesëm mbetet më i ulëti në Evropë, me vetëm një në dy vajza të cilat vazhdojnë shkollimin e mesëm. Varfëria e theksuar gjithashtu ndikon në rezultatin dhe suksesin në arsim. Në teori, arsimi është falas për të gjithë, por ngarkesa financiare për blerjen e librave shkollorë,

ushqimit dhe transportit mbetet plotësisht barrë e familjes kur është fjala te shkollimi i mesëm i lartë i cili nuk është ende pjesë e shkollimit të obliguar. Rreth 34% e të rinjve braktisin shkollën për arsye ekonomike. Dallimet gjinore janë prezente gjatë tërësisht të sistemit arsimor në Kosovë. Statistikat e trendeve të përgjithshme gjinore sikurse është indeksi i paritetit gjinor, niveli i regjistrimit dhe përqindja e regjistrimit të vajzave tregojnë që dallimi gjinor është duke rënë gradualisht në nivelet e ulëta të arsimit. Mirëpo dallimi gjinor rritet në mënyrë të theksuar në favor të djemve gjatë ngjitjes në nivelet e larta të shkollimit. Duhet të analizohen faktorët dhe arsyet e ndryshme për t'ju qasur në mënyrë të duhur arsimit gjithëpërfshirës dhe arsimit të barabartë për të gjithë. Struktura gjinore e mësimdhënësve në arsimin parashkollor dhe para fillor është e dominuar nga femrat, mirëpo numri i femrave bie në mënyrë të theksuar gjatë ngjitjes së niveleve të arsimit. Në shkollimin e mesëm, indeksi i paritetit gjinor është rritur theksueshëm që nga viti 2004, mirëpo ende mbeten vetëm 33% mësimdhënës femra (2008-2009). Në nivelet e larta të shkollimit, kryesisht në Universitetin e Prishtinës, afërsisht janë të punësuar vetëm 25 femra si staf akademik. Sa i përket infrastrukturës, gjatë dekadës së fundit është arritur progres i konsiderueshëm në ndërtimin e shkollave të reja. Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me partnerët zhvillimor ka arritur të reduktoj numrin e shkollave të cilat punojnë në ndërrime të dyfishta përmes përmirësimit të infrastrukturës shkollore dhe krijimit të hapësirave të reja shkollore. Ndërrimet e treta janë eliminuar në masë të konsiderueshme. Aktualisht 24 shkolla janë duke operuar me tri ndërrime, 619 shkolla me dy ndërrime dhe 77 shkolla operojnë me një ndërrim. MASHT-i aktualisht është duke ndërtuar 32 shkolla të reja, prej të cilave 19 shkolla të mesme dhe 13 shkolla fillore. Pasi të jetë përfunduar ndërtimi i këtyre shkollave, numri i shkollave të cilat punojnë në tri ndërrime do reduktohet për 10, ndërsa numri i nxënësve për klasë në shkollat e mesme të larta do të reduktohet gjithashtu (aktualisht numri i nxënësve për klasë është afërsisht 40. Nevojitet planifikim i duhur financiar për mirëmbajtjen e ndërtesave shkollore. Për më tepër shumica e klasave të shkollave duken jo tërheqëse. Ekziston nevoja e transformimit të tyre në klasë më tërheqëse në mënyrë që të bëhen më të këndshme dhe më inkurajuese për mësimnxënie. Arritjet mësimore të nxënësve kryesisht maten nga rezultatet e testeve kombëtare që mbahen në fund të klasës 9 dhe 12. Mesatarja e pikëve të provimit në fund të klasës 5, të klasës 9 dhe të provimit të maturës, është alarmante me 52%, 55%

dhe 47%. Kjo kërkon vëmendje dhe hulumtim të menjëhershëm pasi që ky tregues fundamental pasqyron cilësinë e arsimit në Kosovë. Në përgjithësi, Qeveria e Kosovës ka bërë reforma substanciale në arsimin para-universitar gjatë dekadës së fundit. Janë përcaktuar prioritetet strategjike për arsimin para-universitar të pajtuara me të gjithë aktorët relevant, përfshirë edhe partnerët zhvillimor. Është miratuar legjislacioni primar dhe një numër i konsiderueshëm i legjislacionit sekondar. Është aprovuar Korniza Kombëtare e Kurrikulit e bazuar në kompetenca dhe e cila inkurajon mësimin gjatë gjithë jetës, implementimi i së cilës mbetet sfida kryesore në arsimin para universitar. Është arritur progres i konsiderueshëm në aspektin e trajnimit të mësimdhënësve dhe menaxherëve të arsimit, mirëpo nevojitet punë substanciale para fillimit të implementimit të KKK-së (Zariqi, 2013).

Objektiva e përgjithshme strategjike sipas KESP

- Objektiv e përgjithshme për arsimin para-universitar është që deri në viti 2016 të sigurohet gjithë përfshirje dhe qasje e barabartë në arsimim cilësor dhe jo diskriminues për të gjithë nxënësit për 13 vitet e arsimit të obliguar.

Rekomandimet kryesore

- Ndërtimi i kapaciteteve të komunave dhe drejtorëve të shkollave për marrjen e plotë të përgjegjësi në procesin e decentralizimit të arsimit
- Ndërtimi i kapaciteteve të drejtorëve të shkollave dhe në veçanti të mësimdhënësve me fokus të veçantë në implementimin e Kornizës së Kurrikulit të Kosovës
- Krijimi dhe implementimi i mekanizmit të përshtatshëm për vlerësimin dhe certifikimin e mësimdhënësve dhe alokimi i resurseve për sistemin e gradimit; krijimi dhe implementimi i një sistemi efektiv të trajnimit të mësimdhënësve para shërbimit dhe pa shkëputje nga puna
- Definimi i një sistemi të përshtatshëm dhe të mundshëm për sigurimin e cilësisë i cili përfshinë një sistem të inspektimit i cili përveç çështjeve administrative dhe ligjore në veçanti do të monitoroj, këshilloj dhe të bashkëpunoj ngushtë me shkollat për të siguruar implementimin e politikave arsimore, në veçanti të KKK-së.
- Krijimi i Agjencisë për Kurrikula, Vlerësim dhe Standarde për të këshilluar MASHT-in në fushat përkatëse.
- Krijimi i shërbimeve komunale për këshillim dhe ndërtimi i kapaciteteve të tyre.

- Planifikimi dhe alokimi i burimeve për implementimin e plotë të politikave të gjithëpërfshirjes në arsimin e obliguar në mënyrë që të reduktohet niveli i braktisjes së shkollimit dhe të përfshihen grupet e rrezikuara; fëmijët me nevoja të veçanta, minoritetet, fëmijët që jetojnë në zona të largëta rurale, etj.
- Hartimi dhe implementimi i kampanjave vetëdijësuese për shkollat sa i përket strategjisë ndër-ministore për parandalimin e dhunës në shkolla dhe strategjisë për promovimin e shëndetit në shkolla.
- Zgjerimi dhe përmirësimi i mëtejme i infrastrukturës shkollore: reduktimi i ndërtimeve të shumëfishta, krijimi i klasave tërheqës, zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së TIK-ut në shkolla, përmirësimi i higjienës dhe ngrohjes.
- Përmirësimi i mbledhjes së informatave dhe të dhënave dhe sistemit të përpunimit të tyre (SMIA) dhe trajnimi i zyrtarëve përgjegjës në MASHT, komuna dhe shkolla në mënyrë që të përmirësohet vendim marrja e bazuar në informata - Harmonizimi i legjislacionit primar dhe sekondar në linjë me Ligjin për Arsimin ParaUniversitar dhe harmonizimi i legjislacionit të nën-sektorëve për të siguruar qasje kohezive ndaj reformave të arsimit (Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian, 2013).

2.4.3. Arsimi dhe Aftësimi Profesional (AAP)

Arsimi dhe aftësimi profesional është njëri nga nën sektorët më të rëndësishëm i cili përgatitë individët për punë, përkatësisht pajis ata me shkathtësi, njohuri dhe kompetenca të nevojshme për tregun e punës. Arsimi i mesëm profesional është i ndarë në dy drejtime: arsimi i përgjithshëm profesional i bazuar në shkolla i cili është nën përgjegjësinë e MASHT-it dhe trajnimi e ritrajnimit i të papunëve i cili është nën përgjegjësinë e MPMS-së. Nën sektori i AAPsë është pjesë e nivelit të arsimit të mesëm të lartë (ISCED 3) dhe u shërben grup moshave 15-18 vjeç.

Korniza ligjore në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional përfshinë Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional i miratuar në vitin 2006. Aktualisht ky ligj është duke u rishikuar i cili synon të eliminoj zbrazëtirat në arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin dhe aftësimin për të rritur, për të bërë AAP-në një faktor të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të bazuar në nevojat e tregut të punës, sigurimin e cilësisë të bazuar në standardet dhe kriteret evropiane, harmonizimin me legjislacionin kombëtar

në fuqi. Në vitin 2008 është miratuar Ligji për Kualifikimet Kombëtare i cili ka për qëllim krijimin e Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve, që bazohet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe rregullohet nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK). Pastaj është miratuar udhëzimi administrativ për kriteret dhe procedurat për validimin dhe miratimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë (2011). AKK në korrik të viti 2011 ka filluar procesin e testimit të kriterëve dhe procedurave për validimin dhe miratimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve të cilat ofrojnë arsim dhe aftësim profesional (Dedaj. B & Carabregu. M., 2012).

Në bazë të Ligjit aktual për Arsimin dhe Aftësimin Profesional i miratuar në vitin 2006, është krijuar Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (KAAP). Megjithatë, Raporti i Progresit 2011 i Komisionit Evropian thekson që ky këshill duhet të funksionalizohet plotësisht. Është hartuar një Plan i Veprimit dhe Korniza për Sigurimin e Cilësisë me qëllim të përshkrimit të mënyrave për monitorimin dhe vlerësimin e sigurimit të cilësisë dhe sigurimit të performancës cilësore të shkollave të AAP-së. Reformat aktuale përfshijnë përmirësimin e qasjes në AAP, integrimin e sistemit të ri kurrikular për të gjitha profilet në shkolla, sigurimin i koherencës në mes të nevojave të tregut të punës dhe profileve të ofruara nga shkollat e AAP-së. Është në proces zhvillimi i mëtejme i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në përputhje me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve si dhe akreditimi dhe licencimi i programeve të AAP-së. Kapaciteti institucional i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve duhet të forcohet tutje për implementimin e plotë të Ligjit për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve. Janë duke u ndërtuar kapacitetet menaxhuese me qëllim të krijimit të një qasjeje sistematike për trajnimin e mësimeve të AAP-së. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve gjatë vitit 2011 ka hartuar dhe testuar procedurat dhe kriteret për aprovimin e kualifikimeve profesionale në KKK të cilat do të jenë në përputhje me nevojat e tregut të punës, rritjen e cilësisë së arsimit dhe aftësimin në Kosovë në përputhje me standardet evropiane. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka hartuar një numër të udhëzimeve të cilat do të përkrahin arsimin dhe aftësimin profesional për t'i plotësuar kriteret e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve për tu bërë pjesë e saj. Arsimi profesional është i organizuar në 61 shkolla nga gjithsej 108 shkolla të mesme, ku dy prej tyre janë Qendra të Kompetencës, ndërsa mësimi zhvillohet në disa profile, që përfshin 55.8 % e numrit

të përgjithshëm të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë (59633). Ende nuk ka një lidhje në mes të AAP-së dhe arsimit të lartë. MASHT në bashkëpunim me donatorët është duke implementuar disa programe shkollore të cilat kanë për qëllim të rrisin shkathhtësitë e ndërmarrësisë, respektivisht shkathhtësitë për tregun e punës përmes bashkëpunimit me komani private në të cilat nxënësit kryejnë punën praktike. Megjithatë kjo mbetet vetëm një iniciativë e mirë dhe si hap i mirë që kjo metodë të formalizohet dhe të bëhet pjesë e pandashme e AAP-së. Aktualisht bashkëpunimi mes AAP-së dhe sektorit të ekonomisë pothuajse nuk ekziston. AAP funksionon pothuajse e ndarë nga arsimi i mesëm sekondar i rregullt. Sistemi i AAP-së është kryesisht i bazuar në shkollë dhe ende nuk është i harmonizuar me nevojat e ekonomisë së tregut. Sektori i ekonomisë dhe sektori privat ende nuk marrin pjesë aktive dhe në mënyrë sistematike në planifikimin dhe implementimin e aftësimin profesional. Këshilli Kombëtar për Arsim dhe Aftësim Profesional (KAAP) ka vendosur parakushtet për bashkëpunim institucional mes autoriteteve qeveritare për arsim dhe partnerëve social. Aktualisht, rreth 60% e studentëve të cilët përfundojnë shkollën fillore nuk mund të regjistrohen në shkollat e mesme të rregullta (gjimnaze). Për shkak të vendeve të kufizuara në arsimin e mesëm të rregullt, shumica e nxënësve vijojnë shkollimin profesional për arsye se nuk kanë zgjedhje tjetër. Në vitin 2006, 55% e nxënësve kanë qenë të regjistruar në shkolla profesionale dhe sistemi i AAP-së është konsideruar ende i përshtatshëm vetëm për nxënësit të cilët kanë pasur performancë të ulët. Mos ekzistimi i lidhjes në mes të shkollave profesionale dhe sektorit të ekonomisë e minon tërësisht konceptin e arsimimit dhe aftësimin profesional. Vlerësimi i jashtëm i nxënësve të AAP-së pas përfundimit të klasës së 13 (pra Matura) është krijuar si masë për akomodimin e nxënësve të cilët nuk kanë pasur mundësi të sigurojnë një vend në shkollat e mesme të rregullta por të cilët kanë qenë të interesuar të vazhdojnë arsimimin terciar. Ndërsa pothuajse shkollat profesionale të arsimit të lartë në të cilat mund të regjistrohen nxënësit të cilët përfundojnë shkollën e mesme të lartë pothuajse mungon plotësisht; ekzistojnë 4 shkolla private profesionale të licencuara nga AKK-ja me mundësi të kufizuara të regjistrimit të nxënësve dhe tri shkolla profesionale në gjuhën serbe. Niveli i pjesëmarrjes në arsimin dhe aftësimin jo të obliguar është pothuajse më i ulëti në Evropë. Mungesa e arsimimit për të rritur dhe mësimin të vazhdueshëm jo vetëm që është preokupim kryesor për sistemin e AAP-së por është edhe problem social.

Aktualisht atraktiviteti i AAP-së është i ulët si për nxënësit po ashtu edhe për sektorin e ekonomisë dhe industrisë. Për nxënësit AAP-ja ende nuk ofron shkathtësi të duhura dhe mundësi më të mira për punësim, ndërsa punëdhënësit nuk shohin shkathtësitë e duhura tek ata të cilët kanë përfunduar shkollimin profesional për arsye të mospërputhjes në mes të AAPsë dhe nevojave të tyre. Qendrat e kompetencës vlerësohen dhe konsiderohen të jenë iniciativa të mira për të ngritur vetëdijen për atraktivitetin dhe prestigjin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional si dhe për artikulimin AAP-së me nevojat e tregut të punës duke u bazuar në sektor. Deri më sot qeveria nuk ka gjetur motivuesit kryesor për pjesëmarrje të vërtetë të partnerëve social në planifikimin dhe implementimin e AAP-së. Në përgjithësi një ndër preokupimet kryesore është çështja e kapaciteteve administrative; bërja e politikave në institucionet publike mbetet e dobët (Integrimi Evropian, 2011).

Objektivat e përgjithshme strategjike të PSAK 2011-2016

- Të përmirësohet qasja, cilësia dhe relevanca e AAP-së dhe përmirësimi i koordinimit të tij dhe relevancës për tregun e punës, si dhe forcimi i kapacitetit menaxhues dhe institucional të sistemit të AAP-së dhe sigurimi i një baze të shëndoshë financiare për zhvillimin e qëndrueshëm në plan afatgjatë.
- Të rriten mundësitë për aftësimin e atyre që kanë braktisur shkollimin, për nxënësit e shkollave të mesme të larta dhe për ata që kanë braktisur këto shkolla dhe të rriturit të cilët nuk arrijnë të avancohen në nivelin tjetër më të lartë, e sidomos gratë dhe për rritjen e shanseve për vetëpunësim së bashku me zhvillimin e Qendrave të Kompetencës. Përparësitë - Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
- Autoriteti Kombëtarë i Kualifikimeve është duke forcuar rolin e tij vazhdimisht
- Këshilli Kombëtar për Arsimin dhe Aftësimin Profesional
- Ligji i AAP-së është duke u rishikua për të qenë në përputhje me reformat aktuale
- Vullneti i donatorëve për që të bashkëpunojnë në këtë nën-sektor
- Përkushtimi në rritje i Qeverisë.

Rekomandimet kryesore

- Përgjigja ndaj nevojave profesionale, promovimi i një kulture ndërmarrësie dhe arsimit e aftësimin në ndërmarrësi
- Zgjerimi i hapësirës infrastrukture, duke përfshirë pajisjet adekuate profesionale dhe punën në një ndërrim si dhe zhvillimi i objekteve të përshtatshme për AAP

- Zhvillimi i një formule të veçantë për financimin e shkollave profesionale varësisht nga profilet e tyre.
- Reformimi i provimit të Maturës i cili përfshinë gjithashtu vlerësimin praktik duke pasur parasysh që nxënësit e arsimit profesional janë në disavantazh ngase testohen vetëm në përmbajtje e cila ka të bëjë më shumë me shkollat e përgjithshme
- Zhvillimi i kurrikulave të cilat marrin parasysh kompetencat kryesore të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve por gjithashtu edhe kompetencat profesionale, ndërsa KKK-ja duhet të siguroj mënyra të tjera të regjistrimit të universitet përveç provimit të Maturës.
- Duhet të zhvillohet katalogu për trajnimin e mësimitdhënësve dhe ofruesit e trajnimeve i cili duhet të përfshijë edhe ndryshimet në kurrikulë dhe teknologjinë bashkëkohore
- Finalizimi i Qendrave të Kompetencës dhe krijimi i kushteve që këto qendra të shërbejnë si model për reformimin e shkollave të AAP-së
- Sigurimi i funksionaliteti të plotë të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve e cila do të ketë të regjistruara kualifikime dhe standarde relevante me tregun e punës si dhe institucionet e akredituara për ofrimin e tyre
- Zhvillimi i një sistemi koherent për udhëzimin në karrierë për nxënësit që janë të përfshirë në sistemin e AAP-së si dhe për ata të cilët fillojnë AAP-në për mësim dhe aftësim të mëtutjeshëm.
- Adresuar pabarazinë gjinore në arsim dhe aftësim profesional
- Sigurimi i një bilanci më të mirë në mes shkollave të rregullta dhe arsimit dhe aftësimin profesional të nivelit të mesëm në mënyrë që kjo të shërbej si bazë për zhvillimin e kompetencave të kërkuara nga sistemi socio ekonomik në Kosovë dhe në mënyrë që opsionet për arsimimin e mëtutjeshëm të mbeten të hapura.
- Shikimi i mundësisë së diversifikimit të arsimit të lartë përmes krijimit të shkollave profesionale post-sekondare dhe universitete me programet të orientuara në profesione, si dhe sigurimin e një lidhje më të mirë mes universiteteve dhe ndërmarrjeve.
- Forcimi i kapaciteteve të partnerëve social dhe dhënia e rolit të barabartë në caktimin e agjendës për arsimin dhe aftësimin profesional, formulimin dhe implementimin e arsimit dhe aftësimin dhe politikave të punësimit;

- Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare për sistemin e AAP-së për të krijuar mundësitë për kalimin nga strategjitë në veprime konkrete (Adelman, I. & Morris C.T., 1968).

2.4.4. Arsimi për të rritur dhe arsimi jo-formal

Arsimi i të rriturve është pjesë vitale e politikave të arsimit të BE-së pasi që është esenciale për konkurrencën dhe punësimin, përfshirjen sociale, qytetarinë aktive dhe zhvillimin personal. Sfida kryesore mbetet sigurimi i mundësive për të gjithë, posaçërisht sa u përket grupeve të rrezikuara të cilëve u nevojitet më së shumti arsimi. Ka filluar rishikimi i kornizës ligjore lidhur me arsimimin e të rriturve në mënyrë që të bëhet harmonizimi i tyre, respektivisht janë duke u rishikuar ligji i arsimit dhe aftësimin profesional, ligji për kornizën kombëtare të kualifikimeve, ligji i punës, ligji për fuqizimin e rinisë dhe ligji për arsimimin e të rriturve. Në bazë të Ligjit për Arsimin e të Rriturve të miratuar në vitin 2005 dhe i cili aktualisht është duke u rishikuar, arsimi dhe aftësimi për të rritur nënkupton tërë arsimin dhe aftësimin publik dhe privat të ofruar për të rriturit dhe / ose për të rinjtë mbi moshën 15 vjeçare, të cilët kanë të drejtë të ndjekin programet e mësimin, të hartuara për të rriturit. Në bazë të këtij ligji, arsimi dhe aftësimin për të rritur është pjesë integrale a sistemit të arsimit në Kosovë. Të mësuarit formal bazohet në programet e mësimin, që ofrohen në institucionet e licencuara të arsimit dhe aftësimin, të cilat përdorin programet e aprovuara dhe të nxjerra nga MASHT-i. Mësimi i tillë është i strukturuar dhe çon në certifikim. Të mësuarit informal nënkupton mësuarit që fitohet në jetën e përditshme, në vendin e punës, në gjirin e familjes ose në kohën e lirë. Të mësuarit joformal bazohet tek programet e mësimin, që dallojnë nga ato të përfshira në përkufizimin e mësimin formal në këtë ligj. Ky mësim mund të realizohet brenda institucioneve të njëjta të arsimit dhe aftësimin, që ofrojnë programe të mësimin formal ose plotësisht në mënyrë të pavarur. Megjithatë, kjo formë e mësimin është sistematike sa i përket objektivave, kohëzgjatjes dhe mjeteve të mësimin. Përderisa certifikimi nënkupton njohjen zyrtare e të arriturave, që njih përfundimin e arsimit ose aftësimin ose realizimin e pranueshëm në një test ose provim. Në kontekstin e arsimit dhe aftësimin të të rriturve, është shprehje formale e të arriturave të nxënësit (në lidhshmëri me shkathtësitë, njohuritë dhe qëndrimet).Këto përkufizime janë në

përputhje me përkufizimet dhe konceptin e Komisionit Evropian për arsimin për të rritur dhe format e arsimit dhe aftësimin. Të nxënit në arsimin dhe aftësimin profesional në sistemin formal tradicionalisht është më i dukshëm dhe më i pranuar në tregun e punës dhe në shoqëri në përgjithësi. Megjithatë viteve të fundit ka filluar të rritet vlerësimi dhe rëndësia e mësimin jo-formal dhe informal dhe në këtë aspekt ekziston nevoja e qasjeve të reja për identifikimin dhe validimin e këtyre përvojave jo të dukshme të edukimit. Duke pasur parasysh një periudhë shumë vjeçare të jo stabilitetit të Kosovës, shumë të rritur kanë humbur mundësinë e arsimit formal. Kosova është në një fazë fillestare të zhvillimit të arsimit për të rritur dhe ende nuk është i rregulluar ofrimi i aftësimin të ngjashëm profesional nga ofruesit privat. Tranzicioni aktual politik dhe posaçërisht ekonomik paraqet sfida të reja për Kosovën në aspektin e ofrimit të mundësive për përfitimin e njohurive dhe shkathtësive të reja për të punësuarit dhe punëdhënësit për të pasur mundësi të konkurrojnë në tregun e punës dhe tu përshtaten nevojave të tij. Zhvillimi i edukimit bazik jo formal për të rritur është nën përgjegjësinë e MASHT-it, ndërsa ofrimi i programeve për zhvillimin e shkathtësive të reja të nevojshme për tregun e punës në kuadër të arsimit jo formal për të rritur është kryesisht nën përgjegjësinë e MPMS-së dhe MKRS-së. (Salihu, Material diskutues për të arriturat, sfidat dhe rekomandimet në fushën e arsimit dhe shkencës në Kosovë, 2012).

Objektivi strategjik (PSAK 2011-2016)

- Të krijohet një mjedis afirmativ dhe të sigurohet partneritet me shoqërinë civile për t'u mundësuar të rinjve dhe të rriturve qasje në mundësi cilësore për nxënie të nivelit themelor, për dije dhe kompetenca të shtuara të popullatës së rritur, duke përfshirë gratë, të pafavorizuarit dhe minoritetet në qasje të barabartë në aftësim cilësor dhe, kështu, duke kontribuar në krijimin e shoqërisë së të nxënit gjatë gjithë jetës dhe përmirësimeve në jetën e njerëzve.

Rekomandimet

- Të krijohet një kornizë e qëndrueshme ligjore për arsimin për të rriturit, përfshirë edhe përcaktimin më të qartë të rolit të palëve të ndryshme të involvuara, të obligimeve financiare dhe definimi i qartë i të drejtave konkrete të qytetarëve për arsim të të rriturve, vendosjen e standardeve dhe monitorimin e tyre.
- Të përmirësohet bashkëpunimi në planifikim dhe organizim në mes të ministrive të ndryshme si: MASHT, MPMS, MEF, MTI e të tjera.

- Të zhvillohen lidhje të qëndrueshme me partnerët socialë dhe me shoqërinë civile.
- Hartohet një strategji për ofrimin e mundësive për arsimim pas nivelit fillestar (pas kurseve të shkrim-leximit) dhe për arsimim të vazhdueshëm për popullatën e rritur në suaza të kornizës së krijimit të një shoqërie drejtë të nxënies gjatë gjithë jetës.
- Të ketë vëmendje e veçantë për nevojat e grupeve të marginalizuara.
- Të zgjerohet spektri i arsimit të të rriturve përtej punësueshmërisë në mënyrë që individët të jenë në gjendje të plotësojnë nevojat e tyre ekonomike, sociale dhe personale përmes arsimit.
- Të krijohet një sistem i qëndrueshëm, operacional dhe i besueshëm për njohjen e rezultateve të arsimit joformal dhe informal.
- Të përmirësohet mbledhja e të dhënave dhe informatave relevante në fushën e arsimit dhe aftësimin për të rritur dhe arsimin jo formal.
- Të përkrahen hulumtimet dhe publikimet në temën e arsimit për të rriturit dhe jo formal.
- Të rishikohen dhe modularizohen kurrikulat dhe materialet themelore mësimore për të përkrahur dhe zhvilluar programe alternative për plotësimin e nevojave të të rinjve dhe të rriturve që kanë mbetur jashtë sistemit dhe të cilët nuk mund të përfitojnë nga arsimimi i rregullt me qëllim të përkrahjes së të nxënit të nivelit themelor dhe të shkathtësive thelbësore për jetë dhe punë.
- Trajnimi i mësimdhënësve dhe ndërtimi i kapaciteteve menaxhuese
- Hartimi i kornizës për sigurimin e cilësisë dhe hartimi i programeve mësimore duke në përputhje me nevojat e të gjitha kategorive të aftësimin për të rritur dhe arsimin jo formal (Komisioni Evropian, 2012).

2.4.5. Arsimi i Lartë

Bashkimi Evropian ka ndërmarr masa konkrete për reformimin e sistemit të arsimit të lartë, i cili është konsideruar të jetë i tejkaluar dhe jo në përputhje me nevojat bashkëkohore, me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjë në vitin 1999. Njëri nga objektivat kryesore të procesit të Bolonjës ka qenë krijimi e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë deri në vitin 2010, ku studentet do të kenë mundësi të zgjedhin programe dhe kurse të studimit nga një gamë e gjerë dhe transparente e ofertave cilësore dhe të

përfitojnë nga procedurat e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve të tyre. Procesi i Bolonjës ka nxitur shumë reforma të nevojshme në Arsimin e Lartë të Bashkimit Evropian për të bërë atë më kompatibil dhe më të krahasueshëm, më konkurrues dhe më atraktiv së pari për evropianët por edhe për studentet dhe stafin akademik nga kontinentet e tjera (Stevens, P. & Weale, M., 2003).

Tri objektivat kryesore të procesit të Bolonjës që nga fillimi kanë qenë krijimi i sistemit prej tre ciklesh (bachelor/master/doktoraturë), sigurimin e cilësisë dhe njohjen e kualifikimeve dhe periudhën e studimeve. Procesi i Bolonjës, përveç që është bërë instrumenti kryesor për reformimin e sistemit të arsimit të lartë në Bashkimin Evropian, ka luajtur dhe luan një rol shumë të rëndësishëm edhe për reformimin e arsimit të lartë në Kosovës, pavarësisht që Kosova nuk është nënshkruese e këtij procesi. Arsimi i Lartë në Republikën e Kosovës rregullohet me Ligjin për Arsimin e Lartë, së pari i miratuar në vitin 2002 dhe i rishikuar dhe miratuar në vitin 2011 me qëllim të harmonizimit me reformat aktuale në sektorin e arsimit. Ky ligj vendos bazën ligjore për rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në përputhje me standardet evropiane si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Si rrjedhojë, MASHT gjatë vitit 2012 ka vazhduar me harmonizimin e legjislacionit sekondar në përputhje me ligjin e ri. Në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë, arsim i lartë konsiderohet arsimimi pas nivelit të shkollimit të mesëm të lartë për të cilin mund të jepen kredi sipas Sistemit Evropian për Transferimin e Krediteve (ECTS), si sistem i adoptuar në kuadër të implementimit të procesit të Bolonjës. Sa i përket politikave, qysh në vitin 2004 është miratuar Strategjia për Arsimin e Lartë 2005-2015, ndërsa në vitin 2011 është miratuar Plani Strategjik Gjithëpërfshirës i Arsimit 2011-2016 i cili po ashtu cakton prioritetet, objektivat dhe synimet edhe për arsimin e lartë. Edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e Deklaratës së Bolonjës ajo zyrtarisht është e përfshirë në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë. Më shumë se 75% të institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë në Kosovë përdorin Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) me qëllim të transferimit dhe akumulimit të krediteve. Sistemi i arsimit të lartë është i organizuar në tri cikle, në përputhje me procesin e Bolonjës i garantuar me Ligjin e arsimit të lartë; Bachelor, Master dhe Doktoraturë. Megjithatë duhet ende punë në konsolidimin e mëtejshëm të këtij sistemi. Përderisa ofruesit e arsimit të lartë mund të jenë publik dhe privat dhe mund të

ofrojnë shërbimet e tyre pasi që të jenë licencuar nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës, si institucion kryesor i pavarur për licencim dhe sigurimin e cilësisë së ofruesve të arsimit publik dhe privat në Kosovë. Kosova tani më ka miratuar Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve e cila implementatohet nga Autoriteti Kombëtarë i Kualifikimeve në bazë të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare dhe ka filluar rishikimi i plan programeve të arsimit të lartë i cili është në përfundim e sipër. Më tej është krijuar Qendra Kombëtare për Njohje Akademike (e ashtuquajtur NARIC) e cila është përgjegjëse për procesin e njohjes së kualifikimeve me qëllimin të promovimit të mobilitetit të studentëve, stafit akademik, hulumtuesve, duke ofruar këshilla dhe informacione sa i përket procesit të njohjes së diplomave dhe periudhës së studimeve të kryera në vendet e tjera. Dhe këtë vit, MASHT-i ka hartuar udhëzimin administrativ për caktimin e formës dhe përmbajtjes së diplomave dhe shtojcave të diplomave të bartësve të arsimit të lartë. Aktualisht, MASHT ka hyrë në fazën e dytë të implementimit të strategjisë për arsimin e lartë, respektivisht fazën 2010-2015, prioritetet e së cilës janë zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe intelektuale.

Në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë, arsimi i lartë në Kosovë ofrohet nga universitet publike dhe institucionet private të arsimit të lartë të akredituara si kolegje, institute dhe shkolla të larta profesionale. Gjithsej janë tri universitet publike; Universiteti i Prishtinës, i Prizrenit dhe i Mitrovicës (i cili ende nuk është pjesë e sistemit të arsimit të Kosovës. Universiteti i Prishtinës është universiteti më i madh publik me gjithsej 17 njësi akademike të shpërndara në 7 rajonet e Kosovës. UP-ja ka gjithsej 121 programe Bachelor, 97 programe Master dhe 29 programe të Doktoratës (2010). Numri i përgjithshëm i studentëve për vitin akademik 2011/2012 ka qenë 52,564. Pastaj Universiteti i Prizrenit i cili u themelua në vitin 2008 i cili gjatë viti akademik 2011/2012 ka pasur 2,784 student. Ndërsa janë të licencuara 22 institucione private të arsimit të lartë të cilat grumbullojnë 51,714 student. Universiteti i Mitrovicës rreth 10,000 student dhe 3 shkolla të larta profesionale në gjuhen serbe me rreth 3000 studentë. Të gjitha institucionet e licencuara të arsimit të lartë të integruara në sistemin e arsimit të Kosovës kanë kaluar nëpër procesin e akreditimit të organizuar nga Agjencia Kosovare e Akreditimit i cili proces ka ndikuar në ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë. Në vitin 2008, MASHT-i ka obliguar të gjitha institucionet e arsimit të lartë të themelojnë Zyrat për Sigurimin e Cilësisë dhe të konsolidojnë mekanizmat e tyre të

brendshëm për sigurimin e cilësisë. Në vitin 2009 të gjitha institucionet e arsimit të lartë kanë themeluar këto zyre në kuadër të projektit të Tempusit “Përkrahja dhe Zhvillimi i Strukturave për Sigurimin e Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Kosovë. Qeveria e Kosovës mbetet e përkushtuar që të zhvillojë politika gjithëpërfshirëse dhe të sigurojë një mjedis të përshtatshëm që promovon qasje të shtuar në arsimin e lartë për të realizuar përfshirjen e 35% të grup-moshës përkatëse (prej 18 deri 24 vjeç) në arsimin e lartë deri në vitin 2015. Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në arsimin e lartë është rritur dukshëm për të arritur pothuajse dyfishin (rreth 18,000 në vitin 2009) krahasuar me numrin e studentëve në vitin 2008 (8,000). Ndërsa aktualisht numri i total i studentëve në të gjitha nivelet e arsimit të lartë vlerësohet të jetë përafërsisht 120,921, ku prej tyre më shumë se 11,000 janë nga komuniteti serb por të cilët nuk janë pjesë e integruar e sistemit të arsimit të Kosovës (Arsimi i Lartë në Kosovë, Korrik 2012).

Sa i përket kurrikulave në nivelin Bachelor dhe Master, janë duke u ndërmarrë reforma në aspektin e krijimit të programeve 3+2 ose 4+1 në programet e këtyre niveleve dhe në aspektin e modernizimit dhe adaptimit të programeve aktuale me nevojat e tregut të punës. Institucionet e arsimit të lartë janë duke i harmonizuar vazhdimisht programet e tyre me plan programe relativisht të krahasueshme me Universitetet Evropiane për të lehtësuar kuptimin dhe njohjen e gradave në nivel ndërkombëtar. Kurrikulat përfshijnë lëndët e obligueshme, lëndët kyçe dhe zgjedhore. Ndërsa doktoratura organizohet përmes punës kërkimore dhe mbrojtjes publike të temës së doktoratës.

Financimi i institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë bëhet në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë. Institucionet e arsimit të lartë mund të financohen me fonde nga Ministria për mësimdhënie dhe kërkime shkencore me interes të përgjithshëm; pagesa për shkollim dhe pagesa tjera që bëjnë studentët; pagesa për shërbime komerciale dhe shërbime të tjera; donacione, dhurata, ndihmesa tjera dhe kontrata me organizma shtetërorë, ndërkombëtarë, publik ose privatë në fushën e mësimdhënies, të kërkimeve shkencore apo të këshillimit. Ndërsa Universiteti i Mitrovicës në bazë të Ligjit për Arsimin në Komuna mund të fitoj fonde edhe nga Serbia përderisa ato bëhen publike dhe transparente. Ndërsa arsimi i lartë privat kryesisht vet financohet.

Në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtar, MASHT-i në vitin 2008 ka themeluar Qendrën Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Arsimin e Lartë, Hulumtim dhe Teknologji me qëllim të promovimit dhe lehtësimit të bashkëpunimit, standardizimit, mobilitetit, tejkalimit të barrierave kulturore në komunikim dhe shkëmbim në fushën e arsimit të lartë në shkallë ndërkombëtare, ngritjen e kapaciteteve hulumtuese, promovimin e programeve evropiane, etj. Kjo qendër merret me Programin e 7 Kornizë FP7 dhe koordinon programet si CEEPUS dhe programet e tjera të BE-së. Edhe pse Kosova ka qenë pjesë e programeve të ndryshme të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit të lartë, vlerësohet që pjesëmarrja e Kosovës në këto programe është ende ulët, sidomos sa i përket pjesëmarrjes në Programin e 7 Kornizë.

Sikurse edhe nivelet e tjera të arsimit në Kosovë, edhe arsimi i lartë ballafaqohet me hapësira të pamjaftueshme **infrastrukturore**.

Në Universitetin e Prishtinës, hapësira e llogaritur për metër katror për student është vlerësuar të jetë 2.9895 (2009). Edhe pse kjo mesatare ndryshon prej fakultetit në fakultet, si për shembull në fakultetin ekonomik mesatarja është 1 metër katror për student në disa fakultete tjera mesatarja arrinë 10 metra katror për student, prapë se prapë kjo mesatare është larg standardeve evropiane, duke pasur parasysh po ashtu edhe rritjen e vazhdueshme të studentëve çdo vit. Po ashtu Universiteti i Prishtinës, si universiteti më i madh publik, ka mungesë të sallave të leximit dhe bibliotekave modern. Gjithashtu infrastruktura e teknologjisë informative është e dobët në të pothuajse në të gjitha fakultetet. Shumë të dhëna ruhen dhe arkivohen në mënyre mekanike dhe nuk ende një koordinim të përgjithshëm të infrastrukturës teknologjike. Në këtë kontekst edhe zhvillimi i e-arsimit apo arsimit online është ende i pazhvilluar dhe ka nevojë të ndërmarrjes së veprimeve konkrete në këtë drejtim si hap i rëndësishëm drejt përmbushjes së gjithë përfshirjes dhe arsimit gjatë gjithë jetës (European Training Foundation, 2008).

Edhe pse Qeveria e Kosovës ka marr vendim për rritjen e pagave të personelit akademik të Universitetit të Prishtinës për gati një fish më të larta, prapë shumica e personelit akademik, përkundër faktit që janë të punësuar me normë të plotë në Universitet, gjejnë punë tjera. Një numër i profesorëve ligjërojnë në universitete private në Kosovë, kurse disa tjerë ligjërojnë edhe në Universitetin shtetëror të Tetovës në IRJ

të Maqedonisë. Përveç kësaj, një numër i anëtarëve të personelit akademik gjithashtu punojnë edhe në institucionet qeveritare (siç janë ministritë, Kuvendi i Kosovës etj) dhe shpesh herë nuk i përmbushin orët e tyre të rregullta në Universitet. Shqetësues mbetet fakti që personeli akademik i UPS-së ka shumë pak kohë për hulumtime brenda Universitetit. Universiteti ofron përkrahje për anëtarët e personelit akademik në hulumtimet e tyre individuale nga të ardhurat që vijnë nga pagesat e studentëve. Kjo bëhet kryesisht në formë të përkrahjes financiare për udhëtim dhe vendosje në vendet ku mbahet konferencat që kanë të bëjnë me hulumtimin. Megjithatë, çështja e kohës në dispozicion për të kryer hulumtime individuale mbetet thelbësore, njëllon sikur përkrahja për hulumtime brenda Universitetit. Duke pasur parasysh që Universiteti i Prishtinës është Universiteti më i madh në Kosovë dhe i pari që ka filluar implementimin e Procesit të Bolonjës, fokusi kryesor bie mbi të dhe ai në të njëjtën kohë shërben edhe si pikë referimi për implementimin e reformave. UP-ja ka themeluar disa struktura kyçe për implementimin e Bolonjës. Zyra e Prorektorit për mësimdhënie dhe kërkime shkencore është drejtpërdrejt përgjegjëse për Procesin e Bolonjës dhe për të gjitha reformat dhe aktivitetet akademike në Universitetin e Prishtinës. Struktura kyçe brenda Universitetit që momentalisht e mbikëqyr zbatimin e Procesit të Bolonjës është Zyra për zhvillim akademik e cila ka funksion të promovimit dhe zbatimit të objektivave të Procesit të Bolonjës. Kjo zyre përmban në vete tri njësi kryesore: Njësinë për sigurimin e cilësisë, Njësinë për koordinimin e ECTS-ve dhe Njësinë e shërbimeve përkrahëse për Studentë (Qendra LINK). Përveç kësaj kjo qendër ka nga një koordinator për zhvillim akademik në çdo fakultet të cilët kanë për qëllim kryesor mbikëqyrjen e Procesit të Bolonjës. Në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtarë, UP-ja është anëtare e Asociacionit të Universiteteve Evropiane dhe shumë strukturave e asociacioneve tjera ndërkombëtare. Në vitin 2009 UP-ja ka pasur afërsisht 89 marrëveshje të bashkëpunimit, 88 prej të cilave kanë qenë me universitet rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare. Në hap shumë i rëndësishëm në aspektin e bashkëpunimit ndërkombëtarë të UP-së është fillimi i marrjes pjesë në projektin e Skemës akademike të Ballkanit për ndërkombëtarizimin e të mësuarit në bashkëpunim me universitetet e BE-së (Basileus) nën programin e Dritares Erasmus Mundus për bashkëpunim të jashtëm (EM ECĒ). Edhe pse në aspektin formal, UP-ja qëndron mirë në aspektin e krijimit të strukturave dhe implementimit të reformave, ende nevojitet një

qasje dhe një kuptim më gjithëpërfshirës i Procesit të Bolonjës dhe procesit të integritimit në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Kjo nënkupton planifikim dhe prioritetizim më të mirë, përshtatje të mëturjeshme të kurrikulave, implementim i metodave më moderne të metodologjisë së mësimdhënies, zhvillim të infrastrukturës në veçanti asaj të teknologjisë së informacionit e cilat do të ndikonte në përshpejtimin e reformave të kërkuara por edhe në reduktimin e proceseve administrative dhe burokratike, bashkëpunim më të madh me komunitetin afarist i cili ende mungon, ofrim të arsimit të lartë profesional, zhvillim të kapaciteteve hulumtuese si nga studentët po ashtu edhe nga personeli akademik, rritje të konkurrencës në arsimin e lartë, etj. Mbi të gjitha, sfida e veçantë ende mbetet sigurimi i cilësisë së arsimit të lartë dhe shndërrimit të UP-së por edhe institucioneve private në institucione të vërteta shkencore, që të dy këto mjaft të rëndësishme për zhvillimin e vendit në të ardhmen dhe përballimin e nevojave të tregut vendor, rajonal, evropian e më gjerë (Salihu, Takimi: Arsimi dhe Shkenca, 2012).

Objektivi i përgjithshëm (PSAK 2011-2016)

- Objektivë e përgjithshme në nën-sektorin e arsimit të lartë është hartimi dhe jetësimi i politikave dhe legjislacionit efektiv dhe të qëndrueshëm për të përkrahur qasjen e barabartë nëpërmjet të ndërtimit të një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të arsimit të lartë cilësor që prodhon studentë të kalibrit të lartë që plotësojnë standardet përkatëse evropiane dhe për rritjen e kapaciteteve për kërkime shkencore. Ky qëllim strategjik synon të ndërtojë arsimin e lartë deri në nivelin që e bën atë kompatibil me trendet e ngjashme në rajon dhe në vendet evropiane dhe që e përkrahë mobilitetin e studentëve e të personelit.

Rekomandimet

- Rritja e pjesëmarrjes dhe sigurimi i qasjes së barabartë në arsimin e lartë
- Integrimi i grupeve të rrezikuara në arsimin e lartë; minoritetet dhe studentët me aftësi të kufizuara
- Sigurimi i rritjes së buxhetit për institucionet e arsimit të lartë dhe shfrytëzimi efikas i resurseve si dhe ngritja e kapaciteteve profesionale për thithjen e fondeve shtesë
- Përshtatja e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës
- Krijimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit me komunitetin afarist dhe nxitja e partneriteti publiko-privat

- Vendorsja e standardeve të cilësisë në mësimdhënie e në kërkime shkencore si dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i mekanizmave për sigurimin e cilësisë
- Caktimi i standardeve dhe kritereve të metodologjisë së mësimdhënies për fushat përkatëse si dhe zhvillimi i mekanizmave monitorues
- Caktimi i standardeve dhe kritereve për zhvillimin e kërkimeve shkencore në institucionet e arsimit të lartë
- Sigurimi i një mjedisi modern për mësimdhënie, nxënie dhe kërkime shkencore
- Të avancohet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe mobiliteti i personelit dhe i studentëve
- Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe informatave për arsimin e lartë në Kosovë (Salihu, 2012).

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Të gjithë e pranojmë se arsimi është shtylla e kombit, dhe të gjithë po ashtu e pranojmë se kombi ynë shqiptarë ka ngecur, stagnuar dhe se nuk është atje ku duhej të ishte. A thua kjo ngecje dhe ky stagnim është si rrjedhojë e problemeve në “shtyllën” e tij? Është e kuptueshme se arsimi dhe në përgjithësi Kosova ka pasur një të kaluar të hidhur. E kaluar kjo që ka ndikuar më shumë se çdo gjë tjetër në mos zhvillimin e vendit. Robëria shekullore ka pasur dhe vazhdon të këtë akoma pasoja të rënda për shoqërinë tonë. Sidoqoftë, Kosova ka vite që është e lirë, pra vite jo ditë, javë as muaj, janë vite. Gjatë këtyre viteve është punuar, por jo aq sa është dashur dhe aq sa ka pasur mundësi të punohet. Është bërë “diagnostifikimi” i problemeve. Por, diagnostifikimi nuk është problemë aq sa është terapia. Duhet pranuar që ka pasur përpjekje për të zgjidhur problemet, megjithatë ato ende janë prezente, të pazgjidhura.

Përveç problemeve infrastrukturore rrjedhimisht atyre hapësinore, shkolla ballafaqohet edhe më një sërë problemesh të tjera. Zbatimi i reformave, cilësia, vlerësimi, edukimi, “thyerja” e trekëndëshit pedagogjik, dhuna, mungesat e shumta të nxënësve, rënia e interesimit apo e motivit për të nxënë, si dhe mosesuesi i nxënësve janë një ndër problemet më madhore në shkollat tona. Sigurisht për t’i zgjidhur të gjitha këto problem duhet angazhim maksimal i profesionistëve, kohë, mjete material dhe mbi të gjitha vullnet. Ajo që duhet të jetë shqetësues për shoqërinë tonë e në veçanti për mësimdhënësit, prindërit dhe ministrinë e arsimit është fakti që për shumë nxënës, shkolla është gjëja më e mërzitshme dhe e neveritshme, që ata duhet bërë. Orët mësimore, janë orët më të gjata për ta, ndërsa zilha është tingulli më i ëmbël me gjithë vrazhdësinë e saj. Andaj, Ministria e Arsimit duhet të zhvillojë politika dhe të hartoj plane, zbatimi i të cilave do të bëjë shkollën një ambient më të dashur, atraktiv dhe stimulues për nxënësit. Kjo do të kishte një impakt direkt në ngritjen e cilësisë, rritjen e interesimit dhe në rezultate më të kënaqshme në përmbushjen e objektivave të parapara në korrikolumin e hartuar nga ministria e arsimit. Një gjë tjetër që vërehet në shkollat tona është, së nxënësit stimulohen në nxënien përmendësh “bilbilistikë” apo “papagallistikë” të lëndëve mësimore, gjë kjo që është e mundimshme, e lodhshme dhe më e keqja jo e dobishme për shoqërinë dhe vetë nxënësit. Nëse qëllimi është vetëm të memorizuarit e të dhënave, atëherë nuk është etike të mundohen nxënësit, këtë gjë tash

shumë mirë mund t'a bëjnë kompjuterët. Ndërsa në anën tjetër nuk vlerësohet, stimulohet dhe "kultivohet" të nxënimit logjik, të menduarit kreativ, dhe të menduarit e pavarur. Ka përjashtime por, shumë nga mësimdhënësit kërkojnë të thuhet, riprodhohen të gjitha ato që janë në tekst pa ndryshuar pikë as prejse.

Pyetjet themelore hulumtuese që janë adresuar në këtë punim janë :

1. Cila është rëndësia e arsimit të lartë për një vend?
2. Cilat janë efektet dhe pasojat kryesore të arsimit të lartë?
3. Cili është ndikimi dhe efektet që ka arsimit të lartë në rritjen ekonomike?

Objektivat e Studimit

Objektivi kryesor i këtij punimi është analizimi dhe studimi i ndikimit të arsimit të lartë në rritjen ekonomike për Kosovën.

Objektivat kryesore janë:

1. Përcaktimi i kontributeve dhe efekteve që ka arsimit të lartë
2. Analizimi i rëndësisë së arsimit të lartë në një vend
3. Studimi dhe analiza e ndikimit të arsimit të lartë në rritjen ekonomike.

Hipotezat që shtrohen në këtë punim janë:

HA.-Arsimi i lartë ka një ndikim pozitiv të rëndësishëm në rritjen ekonomike, shpenzimet e buxhetit mbi arsimin e lartë kanë një ndikim sinjifikativ mbi rritjen ekonomike, arsimit të lartë ka ndikim të rëndësishëm mbi rritjen ekonomike në Kosovë.

HO.-Arsimi nuk ka shumë ndikim në rritjen ekonomike në një vend, aktiviteti ekonomik nxitet nga prodhimi i cili përdor burime natyrore, punë dhe kapital.

4. METODOLOGJIA


Në këtë kapitull paraqitet qasja hulumtuese, strategjia hulumtuese dhe procesimi i të dhënave nga mbledhja e të dhënave deri të analiza e tyre.

Metodologjia e kërkimit përfshin mbledhjen e të dhënave relevante nga metoda të ndryshme kërkimore dhe përpilimin e bazave të të dhënave në mënyrë që të analizohen të dhënat dhetë arrihet ndërtim i duhur i projektit hulumtues. Metodatat e përdorura në këtë studim janë me të dhëna sekondare dhe krahasuese se si në vendet e tjera ndikon arsimit në zhvillimin ekonomik dhe si duhet të përmisohet arsimit në vendin tonë. Tek metodologjia e përzgjedhjes së të dhënave do të aplikohen metoda si grumbullimi dhe përzgjedhja e materialeve të ndryshme (literaturës, ueb faqe, dokumenteve, etj.) nëpërmjet të cilave do të jemi të pasuruar me njohuri rreth rolit të Arsimit në zhvillimin ekonomik të një vendi. Po ashtu për të hulumtuar edhe më tepër rreth temës kam formuluar pyetësor të krijuar me pyetjet e nevojshme për të arritur në rezultatet e nevojshme.

5. REZULTATET

Në këtë kapitull diskutohen rezultatet e fituara nga literatura e shqyrtuar dhe rezultatet empirike nga pyetësi për pyetjet konkrete.


A mendoni që ka ndikim arsimit në zhvillimin ekonomik?



Grafiku 1. Opinionet e qytetarëve rreth ndikimit të arsimit në zhvillimin ekonomik

Në këtë grafik kam paraqitur në mënyrë statistikore opinionet e qytetareve se sa mendojnë që ndikon Arsimit në zhvillimin Ekonomik nga kjo ka rezultuar që 85% e qytetarëve mendojnë që pa dyshim ndikonë, rreth 10% janë përgjigjur nuk e di dhe 5% janë përgjigjur jo.

Duke parë rëndësinë gjithmonë e më të madhe të arsimit të lartë në zhvillimin ekonomik a nevojiten të ndërtohen dhe të zbatohen politikat që synojnë rritjen e pjesëmarrjes në arsim në përgjithësi dhe në arsimin e mesëm dhe të lartë në veçanti?




Grafiku 2. Opinionet e qytetarëve se a nevitin të ndërtohen dhe të zbatohen politikat që synojnë rritjen e pjesëmarrjes në arsim në përgjithësi dhe në arsimin e mesëm dhe të lartë në veçanti?

Një faktor tjetër veçanërisht i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës është arsimimi modern që promovim shkathtësive kyçe të cilat nxisin vetëpunësimin. Së fundi, nivelet më të larta të rezultateve në arsim rrisin shanset e Kosovarëve për të konkurruar me sukses në tregjet e huaja të punës, krahas tregut të brendshëm. Hulumtimet tregojnë se niveli më i lartë i arsimit i personave në forcën e punës rritet probabilitetit për të punuar jashtë. Pra me nivele më të larta të arsimit, remitancat për kokë nga Kosovarët që punojnë jashtë do të rriten dhe nëse edhe gjasat për punë jashtë rriten, këto remitanca do të rriten edhe më shumë. Për këto arsye shpenzimet në arsim duhet të shihen si investime, kthimet nga të cilat do të përshpjetojnë rritjen ekonomike. Është kjo karakteristikë që nxjerr në pah nevojës që Qeveria e Kosovës të caktojë si prioritet ndërtimin e mëtejshëm të një sistemi modern të arsimit dhe, sipas nevojë, rritjen e shpenzimeve të përgjithshme publike dhe private për arsimin.

Duke dikur këtë faktorë të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës në këtë anketë me qytetarët kam dashur ti dija opinionet e tyre se a duhet të ndërtohen dhe të zbatohen politikat që synojnë rritjen e pjesëmarrjes në arsim në përgjithësi dhe në arsimin e mesëm dhe të lartë në veçanti nga kjo ka rezultuar që 90% mendojnë që po nevojitet dhe rreth 10% mendojnë negativisht.


Opinionet e mësimitdhënësve dhe studentëve në lidhje me disponueshmërinë me literaturë

Opinionet e mësimitdhënësve:



Grafiku 3. Opinionet e mësimitdhënësve në lidhje me disponueshmërinë me literaturë

Opinionet e studentëve:




Grafiku 4. Opinonet e studentëve në lidhje me disponueshmërinë me literaturë

Pothuajse të gjitha Fakultetet dhe SHL-të në kuadër të UP-së kanë bibliotekë, por këto biblioteka nuk janë të pajisura si duhet me literaturë për studim. Në përgjithësi, rreth gjysma e mësimitdhënësve të anketuar vlerësojnë se disponueshmëria me literaturë është e mirë, ndërsa opinionet e studentëve në lidhje me këtë qështje janë më negative se sa të mësimitdhënësve.

Në pyetjen se a janë librat të lehta për tu mësuar, 63% e mësimitdhënësve përgjigjen pozitivisht derisa vetëm 31% e studentëve e ndajnë këtë mendim. Megjithatë, kur janë pyetur se a ka mjaft shembuj praktike, studime rasti dhe ilustrime në librat që përdoren, vetëm 39% e mësimitdhënësve dhe 25% e studentëve janë përgjigjur pozitivisht. Rreth 50% e mësimitdhënësve dhe studentëve të anketuar përkrahin idenë e përkthimit në shqip të literaturës së huaj për të mbushur zbrastësinë me literaturë për studim.

Një problem madhor në vendin tonë është mungesa e vazhimit të studimeve të larta, a mendoni që një ndër shkaqet kryesore janë kushtet financiare?



Grafiku 5. Opinonet e qytetarëve që një ndër shkaqet kryesore të mosvazhimit të studimeve të larta janë kushtet financiare

Një problem madhor në vendin tonë është mungesa e vazhimit të studimeve të larta nga nxënës në vështirësi ekonomike, pra nga shtresa e varfër e vendit. Këto student në

vendin tonë nuk janë të përjashtuar nga taksat e shkollës, nuk i marrin librat falas dhe në këtë grafik kam paraqitur opinonet e qytetarëve se sa mendojnë që ndikojnë kushtet finaçiare në mos vazhdimin e studimeve të larta nga kjo ka rezultuar që 85% mendojnë që ndikojnë kushtet finaçiare dhe rreth 15% mendojn negativisht.

6. DISKUTIME DHE KONKLUSIONE

Në këtë kapitull janë përmbledhur pikat kryesore nga i gjithë punimi për të shpjeguar më mirë pyetjen hulumtuese.

Lidhja midis arsimit të lartë dhe rritjes ekonomike përveçse është një lidhje komplekse mbart edhe vetinë e ndërsjellët, e para ndikon tek e dyta dhe e dyta tek e para, duke lënë në një pikëpyetje se kush ka qenë e para që nisi zinxhirin e ndikimeve. Duke ditur që bota dhe historia e saj njohu shumë më përpara rritjen ekonomike ndërkohë që arsimit i lartë akoma nuk ishte krijuar. Për tu lartësuar edhe më shumë rritja ekonomike ishte dhe është e nevojshme që individët të arsimohen dhe të përcjellin brez pas brezi ato që ato kanë përvetësuar nga eksperiencat e tyre. Pra arsimimi jo vetëm përgatit individëve që kanë përvetësuar aftësitë themelore, njohuritë, dhe vlerat përmes arsimit, por duhet të jetë i "aftë" ti ndihmojë ato në aplikimin e njohurive të akumuluar duke i shpalosur këto të fundit si aftësitë në vendin e punës në mënyrë që të kontribuojnë për shoqërinë përmes një kontributi të matshëm në fushën e ekonomisë. Ndaj për këtë arsye ekonomistët prej kohësh janë përqendruar në rolin që arsimit i lartë ka në zhvillimin ekonomik të një vendi.

7. REFERENCAT

- Adelman, I. & Morris C.T. (1968). *An Econometric Model of Socio-economic and Political Change in Underdeveloped Countries*. American Economic Review.
- AKK. (2011, Dhjetor). *Korniza Kombëtare e Kualifikimeve*. Gjetur në Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve: https://akkks.rks-gov.net/uploads/korniza_kombtare_e_kualifikimeve.pdf
- Arsimi i Lartë në Kosovë. (Korrik 2012). *Agjencia Ekzekutive për Arsim, fushën Audiovisuale dhe Kulture, Komisioni Evropian*.
- Barr, G. (2013, Prill 15). *Importance of education*. Gjetur në The Hindu: <https://www.thehindu.com/features/kids/importance-of-education/article4619651.ece>
- Bellaqa, B., Rexhepi, N., Bahtijari, S. R., Uka, A., Uka, L., & Cakolli, A. (2012, Nëntor). *Statistikat e Arsimit 2011-2012*. Gjetur në ASK: <https://ask.rks-gov.net/media/1645/sattistikat-e-arsimit-2011-2012.pdf>
- Bokova, I. (2010). *Education counts: towards the Millennium Development Goals*. Gjetur në UNESDOC: <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000190214>
- Bowen, W.G. (1963). *Assessing the Economic Contribution of Education*. in B.R. Cosin (ed.), *Education: Structure and Society*, 2nd ed., Milton Keynes: Open University Press.
- Dedaj, B & Carabregu, M. (2012). *Sfidat në krijimin e instrumenteve të hulumtimi dhe zhvillimit dhe kapacitetet e Kosovës si shtet në tranzicion*. Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës dhe ËUS Austria.
- European Training Foundation. (2008). *Analiza e Kapaciteteve të Burimeve Njerëzore në Kosovë*.
- Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. (2008, Maj 21). *Ligji për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës (03/L-068)*. Gjetur në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2543>
- GPE. (2013, Gusht). *The value of education*. Gjetur në Global Partnership: <https://www.globalpartnership.org/who%20%80%90we%20%80%90are/the%20%80%90value%20%80%90of%20%80%90education/>
- Hanushek, A. E. & Wobman, L. (February 2007). *The role of education in economic growth*. Gjetur në

<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/7154/wps4122.pdf?sequence=1>

- Integrimi Evropian. (2011). *Raporti i Progresit*. Gjetur në <http://mei-ks.net/sq/raporti-i-progresit-585>
- Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian. (2013, Maj). *Inovacioni, shoqëria e informacionit, politikat sociale dhe shëndetësore - RAPORT*. Gjetur në https://president-ksgov.net/repository/docs/TRT_5_ALB.pdf
- Komisioni Evropian. (2012, Mars). *Efektet dhe ndikimi i programeve të ndërmarrësisë në arsimin e lartë*. Gjetur në Drejtoria Gjenerale për Ndërmarrësi dhe Industri.
- Lauder, H., P. Brown & D. Ashton. (2008). *Education, Globalization, and the Future of the Knowledge Economy* (Vëll. i 7). European Educational Research Journal.
- Memorie, A. (2012, Prill). *Rishikimi i Përbashkët Vjetor i Sektorit të Arsimit*. Gjetur në <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/promemoria-rpv-2012.doc>
- Mexhuani, A., & Gajraku, G. (2008, Shtator). *Ndikimet e trajnimeve në procesin mësimor*. Gjetur në IPK:
<http://archive.erisee.org/downloads/2013/2/Training%20impact%20in%20teaching%202008%20AL.pdf>
- Salihu, A. (2012, Tetor). *Material diskutues për të arriturat, sfidat dhe rekomandimet në fushën e arsimit dhe shkencës në Kosovë*. Gjetur në Task Forca për Integrim Evropian: http://www.mei-ks.net/repository/docs/Material_Diskutues_Arsimi_dhe_Shkenca.pdf
- Salihu, A. (2012, Tetor). *Takimi: Arsimi dhe Shkenca*. Gjetur në IE: http://www.mei-ks.net/repository/docs/1Material_Diskutimi16102012.pdf
- Stevens, P. & Weale, M. (2003). *Education and Economic Growth*. NIESR Discussion Papers 259. Gjetur Prill 1, 2012, nga http://cee.lse.ac.uk/conference_papers/28_11_2003/martin_weale.pdf
- Shkenca dhe Teknologjia në Kosovë. (2008). *Platforma për kërkimet për vendet e Ballkanit Perëndimor*.
- Zariqi, Q. I. (2013, Janar-Dhjetor). *Raport i Progresit për Fëmijë*. Gjetur në Zyra e Kryeministrit: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Progresi_i_Raportit_ALB_01_web.pdf

8. APPENDIXES



Koleji UBT

Drejtimi: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomik

Ky pyetësor është pjesë e temës sime të diplomës për marrjen e titullit Bachelor në Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, në Kolegjin “UBT”. Studimi ka të bëjë me ndikimin që ka Arsimi në zhvillimin Ekonomik të vendit, rasti i Kosovës. Të dhënat nga ky hulumtim do të përdoren vetëm për qëllime studimi prandaj është anonim. Është e rëndësishme që përgjigjet tuaja të jenë të sinqerta për të dhënë rezultate sa më reale, dhe të plotësohen të gjitha pyetjet.

Gjithashtu ju faleminderit për përkrahjen tuaj.

Pyetësori për studentët

Të flasësh në lidhje me ndikimin e arsimit të lartë në ekonomi, lind nevoja edhe të njihesh me mënyrën sesi studentët e shohin rëndësinë e arsimit të lartë kundrejt kontributit që ky i fundit do të japë në punën e tyre të ardhshme. Duke u ndalur njëkohësisht edhe në këndvështrimin sesi drejtuesit e bizneseve e shohin dhe e vlerësojnë kontributin e arsimit të lartë në zhvillimin e biznesit. Për të arritur në krijimin e ideve në lidhje me këto dy këndvështrime janë hartuar pyetësorët për studentë të cilët kanë përfunduar studimet e larta në fakultetin e ekonomisë, por nuk janë diplomuar, dhe për studentë të cilët janë në proces e sipër mësimor. Po ashtu pyetësorë janë hartuar edhe për drejtues të bizneseve për tu njohur edhe më mirë me mendimet dhe mënyrën sesi ata e shohin tregun e punës përballë ndikimit që ka në këtë treg arsimi i lartë. Pyetësorët janë zhvilluar dhe hartuar në mënyrë të tillë që jo vetëm të merret një mendim në lidhje me rëndësinë që studentët dhe drejtuesit e bizneseve shohin tek arsimi i lartë, por edhe me problematikat që ato mund të nxjerrin në pah përmes pyetjeve të hapura, gjysëm të strukturuara dhe të strukturuar. Ky pyetësor lipset të plotësohet nga

persona që nuk kanë mbaruar fakultetin ekonomik dhe janë ose jo në kushte pune në këtë profil.

Pyetësori për studentë që nuk kanë përfunduar studimet

Gjinia: Mashkull Femër

Qyteti i lindjes:

Në cilin vit të studimeve jeni:

1. Dega që vazhdoni:

- a. Financë
- b. Biznes
- c. Ekonomiks

2. Keni përsëritur ndonjëherë vitin?

- a. Po
- b. Jo

3. Nëse jeni në punë, çfarë pune bëni?

4. A mendoni se studimet në universitet do ju ndihmojnë për të bërë punën tuaj në praktikë? Ju lutem jepeni këtë përgjigje duke e vlerësuar me një notë nga 1 në 10.

5. Cila nga lëndët që keni bërë në fakultet ju është dukur që ka më shumë lidhje me praktikën?

6. Cili është tipi(pa emra konkret) i profesorit që do e mbani mend më mirë nga fakulteti?

- a. Ai që shpjegonte me shembuj konkret
- b. Ai që zgjidhte më shumë ushtrime
- c. Ai që ngelte më shumë student
- d. Ai që kalonte më shumë student
- e. Një përgjigje më ndryshe(ju lutem specifikojeni atë)

7. Për student të vitit të parë pyetja do ishte? Në cilën lëndë mendoni se shembujt duhet të jenë më shumë praktik?

8. Nëse do kishit në dorë të ndryshonit dicka në fakultetin e ekonomisë çfarë do të ndryshonit?

- a. Nivelin e mësimdhënies, duhet të jetë më praktik
- b. Shpjegimin e ushtrimeve
- c. Të bëhet më shumë praktikë në firma të ndryshme
- d. Tekstet mësimore, duhet të jenë më të kuptueshëm
- e. Tezat e provimit duhet të shoqerohen me një celës përgjigjesh në fund të provimit, pasi jemi të paqartë se ku kemi gabuar.

9. Jeni përballë një vendimi: Vendimi i parë: "Të diplomoheni, por të mos dini asgjë nga praktika e punës si ekonomist apo si manaxher" Vendimi i dytë: "Të mos diplomoheni, por të jeni njohës shumë i mirë në praktikë i profesionit tuaj" Cilin nga vendimet do të merrnit?

- a. Të parin
- b. Të dytin

10. Zgjedhja e fakultetit ekonomik ishte:

- a. Pjesë e dëshirës suaj
- b. Pjesë e dëshirës së prindërve
- c. Nuk e dëshiroja, por bëra një llogaritje të tipit: "Me ekonomik do gjej gjithnjë punë"
- d. Nuk e dëshiroja, por kjo më doli, nuk fitova dot pikët për fakultetin tjetër që ëndërroja
- e. Kam qenë konfuz/e në lidhje me zgjedhjen që bëra

11. Nëse do ktheheshit edhe një herë në momentin që morrët vendimin për të qenë student të fakultetit të ekonomisë do e ndryshonit vendimin tuaj (pra jeni bërë pishman që zgjodhët fakultetin ekonomik)?

- a. Po, padiskutim që jam bërë pishman, nuk do e zgjidhja si fakultet
- b. Po, padiskutim që më ka zhgënjyer, por do isha e detyruar ta zgjedhë sërish se nuk e di se çfarë pune tjetër mund të bëja
- c. Jo, nuk i kam rënë pishman
- d. Nuk di sesi ti përgjigjem kësaj pyetje
- e. Një përgjigje më ndryshe (ju lutem specifikojeni atë)

12. Keni dëgjuar nga student që janë më të rritur se ju apo që kanë mbaruar studimet shprehjen e tipit: "Asgjë nga ato që bëni në shkollë nuk do ju hyjë në punë?"

- a. Po, shpesh
- b. Po, rrallë
- c. Jo

d. Nuk e mbaj mend

13. Me një notë nga 1 në 10 (ku nota 1-tregon frikën më të ulët dhe 10- frikën më të lartë) sa është niveli i frikës që keni se mos ndoshta nuk do arrini dot të bëni tamam punën e ekonomistit/es, manaxherit/es, marketingut?

Pyetësi për studentë që kanë përfunduar studimet

Gjinia: Mashkull Femër

Qyteti i lindjes:

Vitet e përvojës në punë:

1. Dega që keni mbaruar:

- a. Financë
- b. Biznes
- c. Ekonomiks

2. Jeni diplomuar?

- a. Po
- b. Jo

3. Profili i punës që ju bëni

4. A mendoni se studimet në universitet ju kanë ndihmuar për të bërë punën tuaj në praktikë? Ju lutem jepeni këtë përgjigje duke e vlerësuar me një notë nga 1 në 10.

5. Cila nga lëndët që keni bërë në fakultet ju është dukur që ka më shumë lidhje me praktikën?

6. Cili është tipi(pa emra konkret) i profesorit që e mbani mend më mirë nga fakulteti?

- a. Ai që shpjegonte me shembuj konkret
- b. Ai që zgjidhte më shumë ushtrime
- c. Ai që ngelte më shumë student
- d. Ai që kalonte më shumë student
- e. Një përgjigje më ndryshe(ju lutem specifikojeni atë)

7. Kur keni qenë student, keni parë dhe studjuar bilance dhe pasqyra të tjera financiare reale të firmave konkrete, për shembull të keni marrë në studim një firmë konkrete dhe jo hipotetike dhe të keni studjuar sesi bëhen pasqyrat financiare të saj, librat kontabël, programet etj?

- a. Po

- b. Jo
- c. Nuk mbaj mend
- d. Po, por privatisht, pra jo në fakultet

8. Nëse do kishit në dorë të ndryshonit dicka në fakultetin e ekonomisë cfarë do të ndryshonit?

- a. Nivelin e mësimdhënies, duhet të jetë më praktik
- b. Shpjegimin e ushtrimeve
- c. Të bëhet më shumë praktikë në firma të ndryshme
- d. Tekstet mësimore, duhet të jenë më të kuptueshëm
- e. Tezat e provimit duhet të shoqerohen me një celës përgjigjesh në fund të provimit, pasi jemi të paqartë se ku kemi gabuar

9. Jeni përballë një vendimi:

Vendimi i parë: "Të diplomoheni, por të mos dini asgjë nga praktika e punës si ekonomist apo si manaxher"

Vendimi i dytë: "Të mos diplomoheni, por të jeni njohës shumë i mirë në praktikë i profesionit tuaj" Cilin nga vendimet do të merrnit?

- a. Të parin
- b. Të dytin

10. Zgjedhja e fakultetit ekonomik:

- a. Pjesë e dëshirës suaj
- b. Pjesë e dëshirës së prindërve
- c. Nuk e dëshiroja, por bëra një llogaritje të tipit: "Me ekonomik do gjej gjithnjë punë"
- d. Nuk e dëshiroja, por kjo më doli, nuk fitova dot pikët për fakultetin tjetër që ëndërroja
- e. Kam qenë konfuz/e në lidhje me zgjedhjen që bëra

11. Nëse do ktheheshit vite më parë, do e ndryshonit vendimin tuaj (pra jeni bërë pishman që zgjodhët fakultetin ekonomik)?

- a. Po, padiskutim që jam bërë pishman, nuk do e zgjidhja si fakultet
- b. Po, padiskutim që më ka zhgënjyer, por do isha e detyruar ta zgjedh sërish se nuk e di se cfarë pune tjetër mund të bëja
- c. Jo, nuk i kam rënë pishman
- d. Nuk di sesi ti përgjigjem kësaj pyetje
- e. Një përgjigje më ndryshe (ju lutem specifikojeni atë).

12. Me një notë vlerësuese nga 1 deri në 10, sa arrin fakulteti ekonomik ti përgatisë studentët për punën në realitet?

Pyetësoni për drejtues të kompanive të ndryshme

1. Jeni kompani

- a. prodhuese
- b. tregtuese

2. Jeni kompani

- a. e madhe
- b. e vogël
- c. e mesme

3. Shumica e të punësuarëve në kompaninë tuaj

- a. kanë mbaruar studimet e larta
- b. nuk kanë mbaruar studimet e larta
- c. janë në proces e sipër

4. Besoni më shumë tek individët

- a. që kanë mbaruar studimet e larta brenda vendit
- b. që kanë mbaruar studimet e larta jashtë vendit
- c. nuk bëjmë dallim

5. Besoni më shumë tek individët që kanë mbaruar studimet e larta

- a. në fakultete private
- b. publike

6. Besoni më shumë tek individët që kanë përfunduar

- a. Studimet e larta me rezultate shumë të larta
- b. Me rezultate të ulta
- c. Rezultatet nuk kanë rëndësi, por eksperiencia dhe praktika duhet të jetë e profilit që të na përshtatet
- d. Një përgjigje më ndryshe

7. Kur ju nevojitet të punësoni dikë, si veproni?

- a. Ju vjen ndërmend si fillim ndonjë i afërm
- b. Ju vjen ndërmend ndonjë punonjës brenda kompanisë të cilit mund ti ngarkoni një punë të dytë
- c. Kontaktoni me ndonjë gazetë dhe i thoni që të botoj një njoftim për vend vakant pune
- d. I ndërmar të gjitha të mësipërmet sipas rastit

8. Shumica e të punësuarëve janë:

- a. të rrethit familjar

- b. shoqëror
- c. asnjë nga dy të mësipërmit
- d. nga të dy të mësipërmit

9. Cila është problematika me punonjësit që vijnë me rezultate të larta nga universiteti?

- a. Vështirë të konceptojnë se në një punë të gjithë punonjësit janë njësoj, pra duhen trajnuar njësoj, qofshin me rezultate të larta shkollore, qofshin me të ulta.
- b. Kërkojnë paga të larta vetëm sepse kanë rezultate të larta, jo sepse duhet të performojnë mirë në punë.
- c. Kanë vështirësi bashkëpunimi me individ të cilët ato i vlerësojnë si me status më të ulët se të tyre.
- d. Kanë vështirësi të bëjnë kompromise me kushtet e punës
- e. të gjitha arsyet e mësipërme

10. Arsyet e mësipërme ju kanë frikësuar për të punësuar individ të cilët kanë mbaruar me rezultate të larta shkollore?

- a. Po
- b. Jo
- c. Varet nga profili i punës, për punën e financierit, e cila ngjan si një punë më e standartizuar duket se të përfunduarit e studimeve me rezultate sa më të larta e bëjnë punën shumë më mirë se ato me rezultate të ulta.

Faleminderit për kohën dhe ndihmën tuaj!